




www.koha.mk
Koha



KOHA për
enigmë

■ FAQE 11-14

E përditshme informative

Viti XI • Numri 3213 • E shtunë/e diel 4-5 nëntor 2017

15 DEN

Burg të përjetshëm edhe për Komandat Sulën



Shkup, 3 nëntor - Sulejman Osmani, ndryshe i njohur si Komandat Sula, të premtën, nga Gjykata Penale e Shkupit, në procesin e ndarë gjyqësor për "Lagjen e Trimave", është dënuar me burg të përjetshëm. Gjatë shqiptimi të këtij dënimi, gjykatësi Goran Boshevski, tha se i akuzuari Sulej-

man Osmani, është fajtor për veprën penale "organizatë terroriste" dhe "terrorizëm". Në arsyetimin e aktgjykimit, ai shtoi se Sula, në fazat e mëhershme të procesit gjyqësor, nuk e ka mohuar pjesëmarrjen me grupin e armatosur, por se kundërshtimi i tij ka qenë lidhur me kualifikimin e veprës. "Dëshmitë

material të prezantuara në këtë proces kanë vërtetuar se Sulejman Osmani është fajtor për të gjitha akuzat që i ngarkohen. Me qëllim të sqarimit të dyshimeve dhe paqartësive, opinion më i gjerë në periudhën e ardhshme do të ketë qasje në aktgjykim, komfor informatave me karakter... **FAQE 5**

Analiza për "Shkupi 2014" ende nuk është gati

Me përmendoret do të merret Qyteti



Rezultatet ende nuk janë gati, edhe pse nga ky institucion ka pasur paralajmërim për heqjen e disa monumenteve apo ndryshime në disa objekte që janë ndërtuar si pjesë e "Shkupi 2014".

Por, pavarësisht vlerësimit që do të japë nga grupi punues transformimet që do të duhet të pësojë ky projekt do të duhet të kalojnë për t'u miratuar jo vetëm në Qeveri, por edhe përmes një debati publik

■ FAQE 2

■ GLOBI

"ALLAHU AKBAR", një frazë e përditshme që sulmet e njollosën



Mohamed Andeel, një karikaturist dhe shkrimtar egjiptian, pyet nëse ia vlen të përpiqet t'u mësojë jo-muslimanëve kuptimin e vërtetë të Allahu Akbar. "Nëse u thoni njerëzve që të mos kenë frikë nga diçka", thotë ai... **FAQE 17**

■ GLOBI

Merkeli përsëri gruaja më e fuqishme

FAQE 17

Rusia sfidon orientimin e Kosovës

FAQE 16





Analiza për "Shkupi 2014" ende nuk është gati

Pezullohet Këshilli për furnizime publike

Shkup, 3 nëntor - Qeveria do ta pezullojë Këshillin për furnizime publike përmes propozimit me procedurë të shkurtuar. Pritet që Këshilli të ndërpresë së funksionuari nga dhjetori i këtij viti. Kjo është një nga reformat në sistemin për furnizime publike që i paralajmëroi sot ministri i Financave Dragan Tevdovski në debatin "Reforma në sistemin për furnizime publike". Pezullimi, siç u theksua, është për arsye se me vendosjen e tij furnizimet publike janë bërë më të komplikuar dhe se janë zhvilluar në afat më të gjatë. Mbështetje për reforma janë shprehur nga BE-ja dhe sektori qeveritar. Në kuadër të reformave është paraparë edhe miratimi i ligjit të ri për furnizime publike deri në tetor të vitit të ardhshëm. Ligji për furnizime publike është miratuar në vitin 2017, por me ndryshimet e bëra pastaj, sipas pjesëmarrësve në debat, është vështirësuar zbatimi i tij, ndërsa sistemi për furnizime publike u bë më i largët nga direktivat e BE-së. "Furnizimet publike zbatohen vështirë, kanë barriera të shumta burokratike të pajustificueshme, të cilat jo vetëm që nuk kontribuojnë që të parandalohen keqpërdorimet e mundshme, por sjellin deri në pengojnë në funksionimin e tyre", tha ministri Tevdovski dhe shtoi se përmes reformave do të miratohet ligji i ri modern për furnizime publike konform direktivave evropiane. Ligji për furnizime publike tashmë përgatitet nga ana e Byrosë për furnizime publike. Drejtori Gjorgji Gjorgjievski paralajmëroi se deri në fund të vitit prite të përgatitet projekt teksti i ligjit, i cili do të shkojë në debat publik, për t'u miratuar në tetor të vitit të ardhshëm. Për pezullimin e Këshillit për furnizime publike theksoi se ai nuk e ka plotësuar detyrën e dhënë dhe paraqet frenim për furnizimet publike. Sqaroi se nëse një nga furnizimet publike duhet të përfundojë për 20 ditë, në praktikë kalohet periudhë më e gjatë. Pesë anëtarëve të Këshillit u përfundon mandati dhe Qeveria nuk planifikon t'i vazhdojë, ndërsa të punësuarit në Këshill do të sistemohen përmes Ministrisë së Shoqërisë Informatike dhe Administratës. Mbështetje për reformat, si dhe për pezullimin e Këshillit për furnizime publike është shprehur edhe nga Delegacioni i BE-së, sektori joqeveritar dhe SIGMA OECD.

Me përmendoret do të merret Qyteti, me muzetë Ministria

Rezultatet ende nuk janë gati, edhe pse nga ky institucion ka pasur paralajmërim për heqjen e disa monumenteve apo ndryshime në disa objekte që janë ndërtuar si pjesë e "Shkupi 2014". Por, pavarësisht vlerësimit që do të japë nga grupi punues transformimet që do të duhet të pësojë ky projekt do të duhet të kalojnë për t'u miratuar jo vetëm në Qeveri, por edhe përmes një debati publik

Koha | Evis HALILI

Shkup, 3 nëntor - Prej afro tre muajsh një grup pune i ngritur nga ministri i Kulturës, Robert Allagjovovski po merret me analizimin e megaprojektit "Shkupi 2014". Rezultatet ende nuk janë gati, edhe pse nga ky institucion ka pasur paralajmërim për heqjen e disa monumenteve apo ndryshime në disa objekte që janë ndërtuar si pjesë e "Shkupi 2014". Por, pavarësisht vlerësimit që do të japë nga grupi punues transformimet që do të duhet të pësojë ky projekt do të duhet të kalojnë për t'u miratuar jo vetëm në Qeveri, por edhe përmes një debati publik.

Sa i takon përmendoreve, për shumicën prej tyre, vendimet do t'i zbatojë Qyteti i Shkupit dhe komuna Qendër, ndërsa Ministria e Kulturës do të ketë liri veprimi për atë pjesë të objekteve që janë nën kompetencat e saj. Si përmendore që priten të hiqen janë ato të Andon Llazov- Janev (Qoseto), përmendorja e Nënë Terezës në



KOMISION I POSAÇËM DO TA KONTROLLOJË PROJEKTIN "SHKUPI 2014"

Kryetari i Komunës Qendër, Sasha Bogdanoviq, dje paralajmëroi se do të formohet komisioni i cili do t'i përfshijë punën tërësisht të projektit "Shkupi 2014". "Kjo do të fillojë nga mënyra e vendosjes së përmendoreve, kush jep leje. Për një shënim përkujtimi është kompetente komuna, për disa Qyteti i Shkupit, ndërsa për të tjerat Kuvendi i Republikës së Maqedonisë. Për më të mëdhatë kemi dyshime se nuk janë bërë në përputhje me vendimet e caktuara, kështu që çdo gjë është vendosur në mënyrë të kundërligjshme do të largohet nga ana jonë", tha Bogdanoviq, duke iu përgjigjur një pyetjeje të gazetarëve në komunën e Qendër, e cila sot shënon 41 vjet nga themelimi.

Sheshin e Shkupit, punimet e së cilës nuk kanë përfunduar. Listës do t'i shtohen edhe dy përmendore të tjera, si ajo e Aleksandrit (Luftëtari në kalë) dhe e "Filipit të Maqedonisë", që gjendet përpara hyrjes në Çarshi. Po ashtu pjesë e ndryshimeve do të jenë edhe objektet, si Muzeu i VMRO-së. Këshilltari në Ministrinë e Kulturës, Petrit Saraçini thotë se përgatitja e analizës së të ashtuquajturit Shkupi 2014, është në fazë finale dhe se sh-

pejti pritet që të publikohet. Më pas do të zhvillohet një debat publik për aspektet e ndryshme, të cilat duhet të adresohen përmes institucioneve dhe organeve të ndryshme shtetërore.

"Sa i përket monumenteve, e dimë që shumica dërmuese e tyre nuk janë të realizuara përmes Ministrisë së Kulturës, por Qytetit të Shkupit dhe komunës Qendër, që do të thotë se për dislokimin eventual të tyre,

apo edhe për ndonjë veprim tjetër ndaj këtyre monumenteve duhet të përcillet procedura ligjore, do të thotë që vendime të tilla mund të marrin ato që i kanë vendosur këto monumente. Sa i përket objekteve të tjera që janë nën ingerencë të drejtpërdrejtë të Ministrisë së Kulturës, si Muzeu i VMRO-së, konsiderojmë se jemi përballë një situatë tejet të koklavitur, pikësepari se ky objekt nuk i përmbush standardet e muzeologjisë, po ashtu ky muze nuk arrin të vlerësojë nga një distancë objektive historike historinë e Maqedonisë e cila është vendosur aty. Që do të thotë se bëhet fjalë për një vizurë ideologjike dhe për këtë muze do të duhet të bëhet një elaborat i veçantë që do të adresojë të paktën këto dy çështje - vendosjen e standardeve dhe e dyta është deideologjizimi i tij, në mënyrë që ai të tregojë një tjetër rrëfim nga një distancë objektive dhe jo ideologjike, duke i përmbushur kështu të gjitha kriteret që të luajë rolin e tij", thotë Saraçini.

Grupi punues për të analizuar projektin "Shkupin 2014" u formua në muajin korrik dhe në të bëjnë pjesë arkitekti Miroslav Gërçev, që është edhe koordinatori i grupit, komunikologu Nikolla Naumovski, arkitekti Martin Panovski, historiania Donka Barçeva dhe kritiku Zlatko Teodosievski. Pak kohë më parë ministri Allagjovovski u shpreh i rezervuar për të komentuar punën e grupit, duke thënë se "Shkupi 2014" është projekt i ndërlikuar dhe kompleks dhe se për disa propozime fillestare që janë bërë nga anëtarët e grupit punues do të duhet të vendosë Qeveria.

Pas dizelit, do të shtrenjtohen edhe cigaret!

Shkup, 3 nëntor - Sipas planit për rritjen e akcizës në prodhimeve të duhanit, prej 1 qershori të vitit të ardhshme çdo kuti e ciga-

reve do të shtrenjtohet për së paku 4 denarë, njofton Koha. Kështu do të jetë shtatë vitet e ardhshme, përkatësisht,

secilin vit cigaret do të shtrenjtohen nga 4 denarë për një kuti, që do të thotë se çdo kuti për 7 vjet do të kushtojë për 28 denarë më

shumë. Çmimet do të jenë kështu nëse në ndërkohë prodhuesit nuk vendosin të korrigjojnë çmimet.

(R.K)

Ahmeti takoi shefin e NATO-s në Maqedoni

Komision anketues për rastin e Kumanovës

Tetovë, 3 nëntor - Në selinë e Bashkimit Demokratik për Integritet në Tetovë, Ali Ahmeti të premten ka pritur në takim punëshefin e zyrës së NATO-s në Maqedoni, Gorazd Bartol. Në takim, siç thuhet në komunikatën drejtuar mediave, u diskutua rreth zgjedhjeve të përfunduara lokale, situatës politike në vend dhe rajon si dhe integritetit të vendit tonë në NATO. "Në fillim, Ahmeti komentoj vendimin e gjykatës së shkallës së parë në rastin e Ku-

manovës duke theksuar nevojën e menjëhershme që të zhvillohet një hetim ndërkombëtar për rastin, të shkëmbehen informacione të rëndësishme me Kosovën dhe Shqipërinë, të themelohet një Komision Anketues në Kuvend, ngjashëm si për rastin e Sopotit, në mënyrë që ky rast të zbardhet tërësisht, përfshirë motivet dhe organizatorët, pa lënë asnjë paqartësi të vetme. Ahmeti nënvizoi që takimin e parë me përfaqësues të komunitetit ndërkombë-

tar pas përfundimit të zgjedhjeve e bënë pikërisht me zyrën e NATO-s në vend për të demonstruar dy prioritetet kryesore në periudhën para nesh, reformat në gjyqësor dhe anëtarësimin në NATO", thuhet në komunikatë. Në ditët në vijim, vijon më tej komunikata, presim edhe rrumbullakësim të pjesës normative të Marrëveshjes së Ohrit nëpërmjet të barazisë gjuhësore, ndërsa BDI mbetet e përkushtuar që ti prijë procesit reformues në vend

nëpërmjet të zbatimit të rekomandimeve urgjente të Komisionit Evropian, por edhe ndërtimit të fqinjësisë së mirë dhe tejkallimit të kontesteve që do të hap rrugën tonë drejt Brukselit. "Ahmeti i vlerësoi zgjedhjet si demokratike, të lira dhe të pranueshme nga të gjitha palët, ndërsa nënvizoi që vendi ka nevojë për opozitë të unifikuar dhe konstruktive në mbështetje të reformave dhe proceseve progresive në vend".





Vazhdon procesi ankimor për rrethin e dytë zgjedhor

BESA me 89 padi në Gjykatën Administrative



Aktakuza për "tentim vrasjen" e Selës dorëzohet në Gjykatë

Shkup, 3 nëntor - Pas përfundimit të procedurës së përgjithshme parahetimore, Prokuroria e Shkupit, të premtën, në Gjykatën Penale të Shkupit, e ka dorëzuar aktakuzën kundër dhjetë personave të dyshuar për "tentim vrasjen" e deputetit, njëherësh kryetar i Aleancës për Shqiptarë, Ziadin Sela. Përmes një kumtese për media, Prokuroria e Shkupit ka njoftuar se të dyshuarit do të gjykojnë në bazë të neneve 123 dhe 19 të Kodit Penal të Maqedonisë.

"Të gjithë të akuzuarit së bashku, por edhe të gjithë persona tjerë, për të cilët deri në këto momente nuk është vërtetuar identiteti i tyre, kanë tentuar që ta likuidojnë të dëmtuarin Ziadin Sela. Një pjesë e të akuzuarve gjatë këtij sulmi kanë shfrytëzuar mjete të forta, të cilat i kanë hedhur në drejtim të të dëmtuarit, me çka i kanë shkakuar lëndime të rënda. Ndërkohë, të tjerët duke e shkelmuar dhe goditur, kanë kryer veprën penale për të cilët ngarkohen", thonë nga Prokuroria e Shkupit. Së bashku me aktakuzën e ngritur kundër dhjetë personave të dyshuar për tentim vrasjen e Ziadin Selës, nga Prokuroria kanë bërë të ditur se kanë dorëzuar propozim për vazhdimin e masës së paraburgimit. Nga gjithsej dhjetë të arrestuar deri më sot, me propozim të Prokurorisë, nëntë të akuzuar qëndrojnë në paraburgim, ndërsa vetëm një në burg shtëpiak. Në sqarimin e kësaj kërkesë, Prokuroria thotë se ekzistojnë dyshime të bazuara për vazhdimin e këtyre masave, respektivisht ekziston mundësia që të njëjtit të arratisen, të ndikojnë ndaj dëshmitarëve apo se mund ta përsërisin veprën penale për të cilën akuzohen. Ndryshe, me 27 prill të këtij viti, pasi turma prej qindra njerëzish në mënyrë brutale u fut në Parlament, filluan me demolinin dhe sulmin ndaj deputetëve dhe gazetarëve, ku më së rëndi pësoi deputeti Ziadin Sela. (O.XH)

Kur jemi tek puna e KSHZ-së, VMRO e Gruevskit të premtën ka kërkuar dorëheqjen e kryetarit të këtij institucioni, Aleksandër Çiçakovski, me arsyetimin se është përgjegjësi kryesor përmes të cilit partia e kryeministrit Zaev organizoi, siç thonë nga VMRO, falsifikim të madh zgjedhor

Koha Fatos RUSHITI

Shkup, 3 nëntor - Pas refuzimit që Komisioni Shtetëror Zgjedhor i bëri të gjitha ankesave të partive politike, nga Aleanca për Shqiptarët dhe nga Lëvizja BESA kanë paralajmëruan se do të vazhdojnë ankimin për rrethin e dytë zgjedhor duke parashtruar padi deri tek Gjykata Administrative. Kjo e fundit ka afat 48 orë për të vendosur mbi paditë e këtyre partive. Nga Lëvizja BESA paralajmëruan se do të dorëzojnë gjithsej 89 padi deri te kjo gjykatë, ndërsa presin që paneli gjyqësor që do të vendos - të mos bie pre e ndikimeve politike, por të marrin për bazë parregullsitë e procesit zgjedhor në Komunën e Çairit. "Komisioni juridik po punon intensivisht në përgatitjen e padive, ku gjithsej do të jenë 89. Brenda afatit ligjor do ti dërgojmë këto padi deri tek Gjykata Administrative, nga e cila presim të mos bie pre e ndikimeve partiake, por të marrë për bazë dëshmitë tona për parregullsitë që ishin evidente në Komunën e Çairit dhe atë të Tetovës", thonë nga shërbimi për informim i Lëvizjes BESA. Edhe Aleanca për Shqiptarët shpreson se Gjykata Administrative do të vendosë me paanshmëri dhe profesionalizëm gjatë shqyrtimit të padive të kësaj partie. "Do të dërgojmë padi në Gjykatën Administrative me shpresë se do të pranohen, dhe gjykata përfundimisht do të tregojë paanshmëri dhe profesionalizëm gjatë vendosjes", thonë në Aleancën për Shqiptarët. Një ditë më parë, nga ankesat e parashtruar, KSHZ refuzoi 88 ankesa të Lëvizjes BESA, të cilat ishin akumuluar në një të vetme pasi kishin të njëjta par-



DY TË PADITUR QË GUAJTËN ME ARMË NË ZGJEDHJET LOKALE

Ministria e Punëve të Brendshme ka zbardhur dy raste të personave të cilët gjatë Zgjedhjeve Lokale të vitit 2017 janë fotografuar me armë. Siç theksohet në kumtesën e MPB-së, pas informacionit të marrë nga mediat për personat të cilët gjoja kanë shtënë dhe janë fotografuar me armë gjatë Zgjedhjeve Lokale të vitit 2017, nga ana e Njësitit për trafikim të paligjshëm pranë Sektorit për punë të brendshme Shkup, janë ndërmarrë masa dhe aktivitetet për konfirmimin e besueshmërisë së informacioneve. "Në bazë të Urdhrit nga Gjykata Themelore Shkupi 1 - Shkup është kryer bastisje në shtëpinë dhe hapësirat tjera të personi S.A. (32) nga f. Haraçinë, rajoni i Shkupit. Gjatë bastisjes, nuk janë gjetur mjete të cilat rrjedhin nga vepra penale. Gjithashtu, në bazë të urdhrin gjyqësor është kryer bastisje në shtëpinë dhe hapësirat tjera edhe të personi V.G. (26) nga Shkupi. Edhe të ky person nuk janë gjetur mjete të cilat rrjedhin nga vepra penale", kumtoi MPB-ja. Personat janë privuar nga liria dhe në Stacionin policor Gazi Babë me ta është biseduar, janë bërë shënime zyrtare, pas çka janë lëshuar. Për ngjarjen me shkrim është njoftuar Prokurori publik, theksojnë nga MPB-ja.

regullsi, ndërsa një ankesë është tërhequr për shqyrtim nga partia. Anëtarët e KSHZ-së, gjithashtu, i kanë hedhur poshtë edhe 13 ankesat e parashtruarat nga Aleanca për Shqiptarët për votimin në Strugë, ndërsa një ankesë të LPM-së e refuzoi si të parregullit. Kur jemi tek puna e KSHZ-së, VMRO e Nikolla Gruevskit të premtën ka kërkuar dorëheqjen e kryetarit të këtij institucioni, Aleksandër Çiçakovski me arsyetimin se është përgjegjësi kryesor përmes të cilit partia e Zoran Zaevit organizoi, siç thonë nga VMRO, falsifikim të madh zgjedhor. "Komisioni Shtetëror Zgjedhor

dhe Qeveria e LSDM-së realizoi zgjedhje katastrofale dhe kriminale, me të vetmin qëllim që të humb VMRO-DPMNE nga falsifikimi masovik zgjedhor. Për të gjithë këtë, përgjegjës është Çiçakovski dhe për këtë arsye kërkojmë nga ai dorëheqje të shpejtë. Një e treta e vendeve zgjedhore të votimit në Maqedoni ishin target të falsifikimit zgjedhor të udhëhequr nga LSDM-ja, Maqedonia e kishte ciklin zgjedhor më katastrofal në historinë e saj, e cila e largoi demokracinë nga Maqedoni dhe e ktheu procesin politik të viteve të zymta të nëntëdhjetës", theksohet në komunikatën e VMRO-së për

media. Nga kjo parti, si argument për zgjedhjet kriminale përmendet lirimi i përkohshëm i Agim Krasniqit dhe përdorimi e të ashtuquajturit "treni bullgar" në kohën e zgjedhjeve. "LSDM po krijon shtet të robëruar, ku frika është mjeti kryesor i qeverisjes. Është shumë e qartë pse kriminelin si Agim Krasniqi ishin liruar para zgjedhjeve. Injorimi i raportit të OSBE-së nga ana e Qeverisë, ku konstatohet ekzistimi i të ashtuquajturit 'treni bullgar' në kohën e zgjedhjeve, është dëshmi se zgjedhjet ishin kriminale", theksohet në komunikatën e VMRO-DPMNE-së opozitare.

VMRO ME MË SHUMË REKLAMA

Në rrethin e dytë të fushatës zgjedhore për Zgjedhjet lokale, vëllimi më i madh i reklamimit të paguara politik është regjistruar për Koalicionin e kryesuar nga VMRO-DPMNE, rreth 26 orë, pas së cilës pasojnë Koalicioni i kryesuar nga LSDM-ja me rreth 11 orë, BESA, rreth 5 orë, dhe BDI rreth katër orë, tregon monitorimi i Agjencisë për Agjencia për Shërbime Mediale Audio dhe Audiovizuale (ASHMAA). Nga televizionet e përfshira me monitorim, më shumë reklama janë transmetuar në TV Nova (pothuajse 12 orë) dhe në TV Sitel dhe TV Alsat-M (rreth 5 orë). Siç kumtoi LSM, radioshpërndarësit e përfshirë me monitorim në rrethin e dytë të Zgjedhjeve lokale, fushatën e kanë përfshirë me intensitet më të vogël, në përgjithësi duke tentuar që të sigurojnë kushte të barabarta për qasje deri te programet e pjesëmarrësve në zgjedhje. Në dhjetë ditët e fundit të fushatës zgjedhore, shkelje e kërkesës për mbulim jo të njëanshëm të zgjedhjeve është konstatuar tek TV Alfa dhe TV Nova.

Marrëveshja me Bullgarinë ratifikohet javën e ardhshme

Sofje, 3 nëntor - Zëvendëskryeministria dhe ministre e Punëve të Jashtme e Bullgarisë, Ekaterina Zaharieva deklaroi se shpreson që marrëveshja për fqinjësi të mirë me Maqedoninë do të ratifikohet javën e ardhshme në Kuvendin popullor bullgar. Në intervistë për Televizionin bullgar kombëtar, Zaharieva deklaroi edhe se do të formohet komision për histori, me qëllim që ai të mos

politizohet. Lidhur me çështjen për emrin, shefja e diplomacisë bullgare thekson se Sofja para pak kohësh e njohu Republikën e Maqedonisë me emrin kushtetues. "Është e rëndësishme që të takohen njerëzit, të përmirësohet infrastruktura midis dy shteteve. Pesëqind mijë qytetarë të Maqedonisë e vizituan Bullgarinë, ndërsa 350 mijë bullgarë udhëtojnë në Maqedonia. Çështja është se si do të

zbatohet kjo marrëveshje. Nga opozita e atjeshme gjuha ndaj Bullgarisë është tejet e ndryshme. Nacionalizmi i fuqishëm dhe fushata kundër fqinjëve tregoi se nuk sjellin rezultate", tha Zaharieva. Kryeministrit e Maqedonisë dhe Bullgarisë, Zoran Zaev dhe Borko Borisov më 1 gusht të këtij viti në Shkup e nënshkruan Marrëveshjen për fqinjësi të mirë dhe miqësi midis dy vendeve. Të

dytë marrëveshjen e vlerësuan si hap historik e cila do të trasojë rrugë drejt stabilitetit të së dy vendeve dhe rajonit. Me dokumentin i cili duhet të ratifikohet në dy parlamentet, mes tjerash parashikon edhe formim të Komisionit për çështje historike dhe arsimore, në bazë pariteti, që të kontribuojë që në mënyrë objektive dhe të bazuar në dëshmi interpretim shkencor i ngjarjeve historike.





Kronikë

Vidhet bastorja në Tetovë

Të enjten mbrëma, rreth orës 23.00, një person i panjohur ka kryer plaçkitje në bastoren sportive "Mozzart", e lokalizuar në rrugën "Todor Cipovski-Merxhan", në Tetovë. I panjohuri, me një kapuç të zi në kokë, ka hyrë në bastoren sportive dhe me anë të një thike i është kërcënuar të punësuarit në bastore, i cili ka qenë duke pastruar objektin dhe nga sirtari i tavolinës së punë ka marrë rreth 20 mijë denarë dhe më pas me shpejtësi është larguar. Megjithatë, për një kohë të shkurtër kryerësi i kësaj plaçkitjeje është identifikuar dhe në prezencë të prindit dhe një përfaqësuesi të qendrës për punë sociale, është arrestuar. Bëhet fjalë për një minoren 17-vjeçar, i cili edhe më parë ka qenë i involvuar në veprimtari të këtitilla ose të ngjashme kriminale. Po ndërmerren masa dhe aktivitete për zbardhjen e tërësishme të rastit, pas çka kundër 17-vjeçarit në fjalë do të pasojë edhe padi adekuate.

Vidhen gështenja në fshatin Otujë

42-vjeçarja me iniciale V.A nga Shkupi, të enjten mbrëmë ka denoncuar se deri më tani persona të panjohur në datën 28 muajt të kaluar kanë kryer vjedhje në vikend-shtëpizën e sajë në Otujë të Tetovës. Pasi me forcë kanë hapur derën hyrëse prej druri, nga brendia e vikend-shtëpizës kanë marrë 5 thasë me rreth 300 kilogram gështenja. Po punohet në zbardhjen e plotë të rastit dhe zbulimin e autorëve të kësaj vjedhjeje.

Aksident në Tetovë, dy të lënduar

Të enjten mbrëma rreth orës 19.45 minuta në fund të rrugës "Marshall Tito", në Tetovë ka ndodhur një aksident komunikacioni në të cilin është përfshirë një veturë e tipit "Opel Astra", me targa të Tetovës, e drejtuar nga 42-vjeçari me iniciale S.O nga fshati Çellopek si dhe një motoçikletë e tipit "Baotian", gjithashtu me targa të Tetovës, të cilën e ka drejtuar 29-vjeçari me iniciale E.S. nga Tetova. Në këtë aksident, motoçiklisti si dhe bashkudhëtarit i tij 17-vjeçar, për pasojë kanë marrë lëndime trupore dhe me anë të një veture tjetër janë dërguar në spitalin e Tetovës, nga ku pas marrjes së ndihmës mjekësore janë lëshuar për mjekim shtëpiak. Sipas njohurive fillestare që dalin nga ekspertiza e kryer në vendngjarje, shkak për këtë aksident është mospërshtatja e shpejtësisë, përderisa dëmi i shkaktuar material vlerësohet që të jetë rreth 15 mijë denarë. (U.H)

Maqedonia jo vetëm që ngec pas shteteve të rajonit lidhur me barazinë gjinore, por shënon edhe rënie të madhe në periudhën 2006-2017 edhe në pjesëmarrjen e femrave në politikë, mundësive ekonomike dhe arsimin, ndërsa i vetmi përparim është arritur në fushën e shëndetësisë në 11 vitet e fundit

Koha | Fisnik PASHOLLI

Shkup, 3 nëntor - Maqedonia renditet e fundit në rajon lidhur me barazinë gjinore. Sipas raportit të vitit 2017 të Forumi Ekonomik Ndërkombëtar për hendekun gjinor, Maqedonia gjendet në vendin e 67-të në botë, duke ngecur pas të gjitha shteteve të rajonit. Në raportin e 144 ekonomive botërore, para nesh renditen Shqipëria në vendin e 38-të, Serbia është e renditur në vendin e 40, Kroacia në vendin e 54-ët dhe Bosnje e Hercegovina në vendin e 66-të. Pas nesh është vetëm Mali i Zi, në vendin e 77-të. Studimi bazohet në disa kritere, si gjendja shëndetësore e femrave, e drejta e tyre arsimore, pjesëmarrja e tyre në politikën dhe ekonominë e vendit dhe mënyra si trajtohet, si mbijeton etj.

Maqedonia jo vetëm që ngec pas shteteve të rajonit lidhur me barazinë gjinore, por shënon edhe rënie të madhe në periudhën 2006-2017, edhe në pjesëmarrjen e femrave në politikë, mundësitë ekonomike, arsimin, ndërsa i vetmi përparim është arritur në fushën e shëndetësisë në 11 vitet e fundit. Raporti për vitin 2017, tregon se, sipas kriterit të barazisë ekonomike, gjegjësisht për mundësitë dhe participimin ekonomik të femrave, Maqedonia renditet në vendin e 96-të në botë. Dobët qëndrojmë edhe me shkathtësitë dhe arritjet në edukimin e femrave, ku renditemi në vendin e 90-të në botë. Më mirë renditemi, në vendin e 65-të në botë, për barazinë gjinore lidhur me shëndetin, si dhe fuqinë politike që zotërojnë gratë, ku ren-

FEN publikon Raportin 2017

Barazia gjinore, Maqedonia e 67-ta në botë



ditemi në vendin e 58-të në suaza globale. Gjithashtu raporti zbardh se në vitin 2017, krahasuar me vitin 2006, shënojmë rënie gati në të gjitha treguesit që tregojnë pozitën e femrave në shoqëri. Përderisa në vitin 2006, pjesëmarrja e femrave në ekonomi ishte mjaft e volitshme dhe si shtet renditeshim në vendin e 31-të në botë, 11 vite më vonë për këtë

tregues renditemi në vendin e 96-të në botë. Lidhur me arsimin e femrave, në vitin 2006 jemi renditur në vendin e 64-të në botë, ndërsa 11 vite më vonë kemi zbritur në vendin e 90. Rënie shënojmë nga vendi i 28-në vitin 2006 në vendin e 58-të në vitin 2017, edhe me fuqinë politike të grave. I vetmi përparim është arritur lidhur me shëndetin e grave ku shënohet

një avancim i dukshëm prej vendit të 101-të në vitin 2006, në vendin e 65-të në vitin 2017. Nga ana tjetër, shtetet nordike vijnë në ruajtje majat e indeksit, për shkak se kanë shumë dekada që investojnë te njerëzit përmes shtetit social, që garanton nivel arsimor dhe kujdes shëndetësor të barabartë. Megjithatë, edhe këto vende nuk konsiderohen tërësisht të barabarta. Islanda, Norvegjia dhe Finlanda vazhdojnë të mbeten në tre vendet e treta, duke i falënderuar se kanë demokraci dhe ekonomi të konsoliduara. Megjithatë, edhe këto vende nuk konsiderohen tërësisht të barabarta lidhur me barazinë gjinore.

Në fund të listës gjenden Irani, Siria dhe Jemeni, që lidhet jo vetëm me konfliktet, por edhe zakonet dhe traditat, thekson raporti. Ndryshe, për përcaktimin e indeksit të hendekut gjinor shfrytëzohen të dhënat nga ekonomia, arsimi, shëndeti dhe fuqia politike në 144 vende botërore.

TRE MILIONË EURO PËR KREDI PËR GRATË NË BIZNES

"Zhvilloni biznesin tuaj: zgjeroni biznesin tuaj jashtë kufijve të vendit" është tema e seminarit të dytë "Gratë në biznes", i cili u mbajt nga banka "Tutunska", në bashkëpunim me Bankën Evropiane për Ripërtëritje dhe Zhvillim (BERZH). Seminari është pjesë e programit "Gratë në biznes" të financuar nga BERZH, Suedi, Luksemburg dhe Fondit Special të Aksionarëve të BERZH-it dhe i implementuar në bashkëpunim me bankën NLB SHA Shkup. Në seminar morën pjesë rreth 40 përfaqësues dhe liderë të kompanive të cilët kishin mundësi të marrin këshilla të dobishme se si të zhvillojnë dhe zgjerojnë biznesin e tyre jashtë vendit. Programi kreditor për për "Gratë në biznes" është në pajtim me marrëveshjen në lartësi prej tre milionë euro për mbështetjen e grave sipërmarrëse në Maqedoni mes

bankës NLB dhe Bankës Evropiane për Ripërtëritje dhe Zhvillim (BERZH). Kjo është pjesë e një nisme rajonale për Ballkanin Perëndimor - Gratë në biznes. Ky program gjithëpërfshirës është hartuar për promovim sipërmarrjen në gratë, duke ndihmuar ndërmarrjet e vogla dhe të mesme të drejtuara nga gratë për të hyrë në shërbime financiare dhe këshilldhënëse, duke u mundësuar të realizojnë rritje në punën. Programi "Gratë në biznes" është dedikuar dhe e fokusuar në mënyrë speciale ndaj ndërmarrjeve e vogla dhe të mesme të drejtuara nga gratë. Mundëson qasje deri te kreditë në vlerë deri në 300.000 euro për financimin e mjeteve themelore, por edhe të mjeteve për punë vijuese, me kushte shumë të volitshme, me afat të pagesës deri në pesë vjet.

Mbi 20 vjet burg për vjedhjen e NLB-Bankës

Shkup, 3 nëntor - Mbi 20 vjet burg Gjykata Penale e Shkupit ju ka shqiptuar të akuzuarve për vjedhjen milionëshe që ndodhi para disa muajve në NLB-Bankë në Shkup. I akuzuari i parë, në këtë rast Boban Smilevski, është dënuar me nëntë vite e dy muaj heqje lire. Më tutje, vëllai i tij Goran Smilevski, i cili po ashtu u akuzuar për veprën penale "vjedhje të rëndë", u dënua me gjashtë vite e gjashtë muaj burg. Ndërkohë, i akuzuari i tretë, Boris Miçevski, në aktakuzë është ngarkuar si transportues i parave të vjedhura, me çka Gjykata, i shqiptoi dënimin me burg prej pesë vite e dy muaj. Ndryshe, i akuzuari i katërt Miroslav Kaevski, i punësuar si trezorist në NLB-Bankë Shkup, është dënuar me burg me kusht, nëse gjatë dy viteve të ardhshme bënë ndonjë vepër tjerët penale, atëherë me automatizëm do t'i aktivizohet edhe ky dënim. Në

arsyetimin e aktgjykimi, gjykatësi Darko Todorovski, tha se ky vendim është bazuar në pranimin e veprës nga të akuzuarit, ndërsa lartësia e dënimeve ka qenë në përputhje me faktin se të akuzuarit nuk kanë treguar se ku gjenden paratë e vjedhura. Njëkohësisht, me këtë aktgjykim të tretë të akuzuarit e parë obligohen brenda një viti, nga dita kur aktgjykimi do të hyjë në fuqi, në mënyrë solidare ta kompensojnë dëmin e NLB-Bankës. Fillimisht prokuroria publike në aktakuzën e ngritur në korrik të këtij viti për vjedhjen milionëshe në NLB-Bankë-Shkup, i ngarkoi tetë persona, ndërsa më vonë numri i të akuzuarve u ulë në katër. Në bazë të përshkrimit të aktakuzës, nga NLB-Banka Shkup, në prill të këtij viti janë vjedhur rreth 3 milionë euro, ndërkohë që edhe sot e kësaj dite nuk janë gjetur paratë. (O.XH)

Këtyre ditëve dërgohet kërkesa për ekstradimin e Grujevskit dhe Boshkoskit

Shkup, 3 nëntor - Ministri i Drejtësisë, Bilen Saliji, të premten deklaroi se këtyre ditëve zyrtarisht do të nënshkruhet dhe dërgohet kërkesa për ekstradim të Goran Grujevskit dhe Nikolla Boshkosit nga Greqia në Maqedoni. Saliji, i cili mori pjesë në prezantimin e raportit për bashkëpunimin me Akademinë franceze kombëtare për jurisprudence, konfirmoi se Gjykata Penale më 1 nëntor e ka kompletuar dokumentacionin e nevojshëm për ekstradim dhe e ka dorëzuar deri te Ministria e Drejtësisë për procedurë të mëtejshme. Grujevski dhe Boshkoski, siç paraprakisht publikoi MIA, janë në arrest ekstradues në Sela-

nik. Ata dy herë u nxorën para Gjykatës në Selanik për shkak të posedimit të dokumenteve të rrejshme të udhëtimit, por gjykimi u shty për më 1 dhjetor për shkak të mospasjes të përkthyesit nga gjuha greke në atë maqedonase. Grujevski dhe Boshkoski janë të akuzuar nga Prokuroria Speciale Publike për përgjim ilegal dhe për shkatërrim të sistemeve për përgjim, raste të njohura si "Fortesa", "Target" dhe "Fortesa 2". Që të dytë janë arrestuar nga policia greke në aeroportin në Selanik më 18 tetor, gjatë përpjekjes që me pasaporta të rrejshme bullgare të largohen me aeroplan për në Budapest.

Përderisa gjykatësi ia shqiptoi dënimin Sulejman Osmanit, ai gjatë gjithë kohës qëndroi i qetë dhe nuk reagoi, respektivisht pas përfundimit të fjalimit, Sula tha se ky dënim ndaj tij dhe anëtarëve tjerë të grupit i ka prekur 7 milionë shqiptarë. Mes tjerash, ai brohoriti disa herë "UÇK, UÇK"...

Koha Omer XHAFERI

Shkup, 3 nëntor - Sulejman Osmani, ndryshe i njohur si Komandat Sula, të premtën, nga Gjykata Penale e Shkupit, në procesin e ndarë gjyqësor për "Lagjen e Trimave", është dënuar me burg të përjetshëm. Gjatë shqiptimit të këtij dënimi, gjykatësi Goran Boshevski, tha se i akuzuari Sulejman Osmani, është fajtor për veprën penale "organizatë terroriste" dhe "terrorizëm". Në arsyetimin e aktgjykimit, ai shtoi se Sula, në fazat e mëhershme të procesit gjyqësor, nuk e ka mohuar pjesëmarrjen me grupin e armatosur, por se kundërshtimi i tij ka qenë lidhur me kualifikimin e veprës. "Dëshmitë material të prezantuar në këtë proces kanë vërtetuar se Sulejman Osmani është fajtor për të gjitha akuzat që i ngarkohen. Me qëllim të sqarimit të dyshimeve dhe paqartësive, opinion më i gjerë në periudhën e ardhshme do të ketë qasje në aktgjykim, komfor informatave me karakter publik, në të cilën qartë mund të shihet bisedat telefonike që i ka zhvilluar i akuzuari dhe provat tjera material", tha gjykatësi Boshevski, gjatë shqiptimit të dënimit kapital. Përderisa gjykatësi ia shqiptoi dënimin Sulejman Osmanit, ai gjatë gjithë kohës qëndroi i qetë dhe nuk reagoi, respektivisht pas përfundimit të fjalimit, Sula tha se ky dënim ndaj tij dhe anëtarëve tjerë të grupit, i ka

Mori fund gjykimi kundër Sulejman Osmanit

Burg të përjetshëm edhe për Komandat Sulën



EDHE HARADINAJ KËRKON HETIM NDËRKOMBËTAR

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj ka dalë me një deklaratë për media në lidhje me dënimin e Grupit të Kumanovës nga Gjykata e Shkupit. Haradinaj thekson se ministri i Jashtëm i Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli, ka thirr në konsultë të brendshme ambasadorin e Kosovës në Shkup, Ylber Hysa, ndërkohë që për të njëjtën çështje e ka thirrur për sqarim ambasadorin e Republikës së Maqedonisë, në Kosovë. "Kemi përcjellë me kujdes dhe vëmendje të shtuar procesin pas ngjarjeve tragjike në Kumanovë, në maj të vitit 2015 dhe dënimet e shqiptuara nga Gjykata në Shkup. Drejtësia duhet të vihet në vend, duke nisur që nga zbardhja e plotë e ngjarjes me të gjitha dimensionet e saj. Një hetim ndërkombëtar do të ndihmonte zbardhjen e plotë të së vërtetës, për të cilën mundohemi të gjithë", ka thënë Haradinaj.



prekur 7 milionë shqiptarë. Mes tjerash, ai brohoriti disa herë "UÇK, UÇK".

GJPSH-ja ose ndryshe e njohur si gjykata "Svarovski", sipas avokatit Naser Raufi, me këtë aktgjykim e ka vërtetuar tezën publik se gjendet para vdekjes klinike. Duke e komentuar vendimin e Trupit gjyqësor, avokati Raufi, tha se ky dënim, duke u mbështetur në provat që i kanë parashtruar prokuroria, paraqet kryekëput një rast të montuar nga ana e shërbimit sekret.

"Ne mendojmë se kur gjykata do të jep arsyetim me shkrim për këtë aktgjykim, do të ketë problem serioz në sqarimin e faktit se pse nuk u pranuan provat tona shtesë. Për dallim nga lënda e grupit, në këtë rast gjykata tezon publik se gjendet para vdekjes klinike. Duke e komentuar vendimin e Trupit gjyqësor, avokati Raufi, tha se ky dënim, duke u mbështetur në provat që i kanë parashtruar prokuroria, paraqet kryekëput një rast të montuar nga ana e shërbimit sekret.

ky rast është montim politik", tha avokati Raufi. Si për këtë rast, ashtu edhe për klientin të tij të cilat janë pjesë e "Grupit të Kumanovës", ai tha se do të dorëzojë ankesë para Gjykatës së Apelit në Shkup. Për dallim prej të akuzuara tjerë, Sulejman Osmani burgun e përjetshëm do ta ndajë me dy nipat e tij, Nasuf Beqirin dhe Fejzullah Rushitovski, të cilët me 2 nëntor po ashtu u dënuan me burg të përjetshëm. Vëllai i Komandat Sulës, Miftar Osmani, pas përfundimit të procesit gjyqësor për "Lag-

MPJ DËNON DJEGIEN E FLAMURIT TË MAQEDONISË NË PEJË DHE GJILAN

Ministria e Punëve të Jashtme e dënoi incidentin e mbrëmshëm me djegien e flamurit të Maqedonisë në Pejë dhe Gjilan, dje pasi u shqiptuan aktvendimet për rastin "Lagja e trimave". "MPJ shpreh keqardhje dhe dënim për aktin e djeshëm të djegies së flamurit të Maqedonisë nga ana e pjesëtarëve të grupeve tifoze në Pejë dhe Gjilan, Republika e Kosovës. Presim që shërbimet kosovare do të ndërmarin aktivitete për përcaktimin e përgjegjësisë së kryesve", ceket në reagimin e MPJ-së -n. Në shenjë proteste për shkak të vendimit të Gjykatës penale të Shkupit për dënimin e tetë anëtarëve të grupit të Kumanovës me burgim të përjetshëm, mbrëmë në qytetet kosovare Pejë dhe Gjilan publikisht u dogjën flamujt e Republikës së Maqedonisë. Sipas mediave kosovare, flamujt u dogjën në protestat në të dy qytetet për shkak të vendimeve të gjykatës, ku ishin bërë thirrje "shqiptarëve t'i mbrojnë të drejtat e veta, duke luftuar kundër padrejtësisë së shkaktuar nga sllavo-maqedonasit". Mediat theksojnë se në djegien e flamurit të Maqedonisë në Gjilan kanë marrë pjesë edhe anëtarë të grupit të tifozeve "Skifterët". "Në shenjë revolte për padrejtësinë e kryer ndaj heronjve tanë nga shteti sllav i Maqedonisë sonje e dogjëm flamurin e tyre, këtu para përmbledores së legjendarit Agim Ramadani - Katana, në Gjilan. U bëjmë thirrje të gjithë burrshtetasve shqiptarë ta kundërshtojnë këtë dhe ta mbrojnë popullin shqiptar në liri. Shqipërinë do ta bëjmë", porositën nga grupi i tifozeve të klubit futbollistik nga Gjilani. Tetë dënime me burg të përjetshëm, 13 me nga 40 vite, gjashtë me nga 20, një prej 18 viteve, dy nga 14, dy nga 13, dy nga 12 vite burg dhe katër aktvendime liruese u caktoi Gjykata penale të akuzuara për ngjarjet në Lagjen e trimave në Kumanovë në maj të vitit 2015 ku jetën e humbën tetë pjesëtarë të forcave të sigurisë dhe dhjetë persona të grupit të armatosur, ndërkaq u plagosën rëndë edhe rreth dyzetë policë të njëjësve speciale.

jen e Trimave", tha se pret që ndërkombëtarët ta zbardhin në tërësi këtë rast. "Drejtësia si term nuk ekziston në Maqedoni. Nuk është e drejtë shqiptimi i burgut të përjetshëm, kur i gjithë procesi gjyqësor dhe ai më herët kanë qenë të montuar. Rastet për shqiptarët, siç po shihen, çdo herë janë montuar", tha Miftar Osmani.

Ndryshe, në procesin

gjyqësor për "Lagjen e Trimave", 26 të akuzuar u dënuan me 746 vjet burg, 7 me burg të përjetshëm dhe katër të akuzuar u liruan nga akuzat. Në mesin e të akuzuara që u liruan nga akuzat gjendet edhe Fazli Osmani, i biri i Sulejman Osmanit, për të cilët pala mbrojtëse, tha se do të kërkon dëmshpërbim për kohën sa ai padrejtësisht ka qëndruar në paraburgim.

Shtatë të lënduar në tre aksidente në Shkup

Shkup, 3 nëntor - Shtatë persona janë lënduar më lehtë në tre nga gjithsej 13 aksidente trafiku të regjistruara gjatë 24 orëve të fundit në rajonin e SPB Shkup. Në 10 janë shkaktuar dëme materiale. Siç informon MPB-ja, gjatë ditës së enjte policia e trafikut ka zbuluar dhe sanksionuar një numër më të madh të kundërvajtjeve. Tridhjetë e një shoferë kanë lëvizur me shpejtësi më të madhe se sa e lejuara, dy shoferë nuk i kanë respektuar dritën e kuqe të semaforit, dy shoferë nuk u kanë dhënë përparësi kalimit të kalimtarëve në kalim të shënuar për këmbësorë, 16 shoferë e

kanë drejtuar automjetin pa patentë shoferi, gjegjësisht me automjet të paregjistruar, si dhe gjashtë shoferë të cilët kanë përdorur celularin gjatë drejtimit të automjetit. Janë sanksionuar 53 automjete të parkuara në mënyrë jo të rregullt. Me ndihmën e automjetit special "karrotreci" janë larguar 73 automjete. Në kuadër të aksionit të edukimit për komunikacion "T'i mbrojmë fëmijët në komunikacion" Sektori për parandalim sot do të realizojë punëtori edukative me nxënësit e klasës së katërt në SHFK "Kole Nedellkovski" e cila ndodhet në rajonin e komunës Qendër.

Prokurorja Ristovska kërkon materiale të reja

Tani që Trajanovski iku, PSP i futet Qytetit të Shkupit

Nga Prokuroria Speciale Publike kanë thënë se prezenca e prokurores speciale ka pasur të bëjë për një takim pune, pa precizuar se për çfarë bëhet fjalë

Shkup, 3 nëntor - Prokurorja speciale, Lence Ristovska, të premtën ka qëndruar në hapësirat e Qytetit të Shkupit. Nga Prokuroria Speciale Publike kanë thënë se prezenca e prokurores speciale ka pasur të bëjë për një takim pune, pa precizuar se për çfarë bëhet fjalë. Megjithatë, nga raportet e



mediave, thuhet se PSP ka filluar me mbledhjen e të dhënave për një procedurë para hetimore. Jo zyrtarisht, sipas "Makfaksit", kjo vizitë e PSP-së lidhet me fillimin e një bashkëpunimi për mbledhjen e dokumentacionit për projektin megaloman "Shkupi 2014", por edhe për materiale tjera, për të cilat Prokuroria Speciale ka indikacione se është kryer

mi për mbledhjen e dokumentacionit për projektin megaloman "Shkupi 2014", por edhe për materiale tjera, për të cilat Prokuroria Speciale ka indikacione se është kryer

krime, gjithmonë duke u bazuar në materialet e përgjuara. Nga fundi i muajit qershor e deri më sot, PSP kryesisht është marrë me 19 aktakuzat të cilat i dorëzoi në Gjykatën Penale të Shkupit, një pjesë të cilave e kanë kaluar fazën e vlerësimit dhe pritet që së shpejti të fillojnë proceset gjyqësore. Ndërkohë, përkundër apeleve dhe kërkesave nga kjo prokurori, Ligji për vazhdimin e mandatit të PSP-së, në pjesën e ngritjes apo parashtrimit të aktakuzave, ende nuk është futur në procedurë parlamentare. (O.XH)



Para një muaji kur u lëshua në përdorim ujësjellësi i ri, i cili me ujë furnizohet nga Lumi Shkumbin dhe Leshnicë, me ç' rast qyteti ka edhe 200 litra ujë shtesë, megjithatë pas normalizimit të gjendjes me ujin, tetovarët tashmë përballen me një problem tjetër

Koha Urim HASIPI

Tetovë, 3 nëntor - Gati se dy javë uji i pijshëm në Tetovë ka shijë dhe erë tjetër nga ai që ishin mësuar qytetarët më herët të konsumonin. Së këndejmi, kjo ka bërë që qytetarët të kenë frikë për të konsumuar ujin që rrjedh në çezmat e tetovarëve. Ata druajnë se uji me shijë dhe erë tjetër të pakëndshme, mund edhe të jetë i përhershëm, por kohëve të fundit, sipas informacioneve jozyrtare, është rritur dukshëm blerja e ujit të ambalazhuar në shitore dhe markete në Tetovë.

"Kohëve të fundit me shumë blejmë ujë të ambalazhuar se sa të përdorim ujin nga çezma në shtëpi, i cili ka një erë dhe shijë të pakëndshme. Prandaj, edhe gjithnjë ble-



jmë ujë nga shitoret e lagjes, sepse kemi dyshime", thotë Bekimi, një banorë i Tetovës.

Përgjegjësit e arsyetojnë panikun dhe shqetësimin e banorëve të Tetovës, që ka të bëjë me ujin e pijshëm. Por, Ata thonë se megjithatë vend për panik nuk ka, sepse të

gjitha analizat tregojnë se uji edhe në aspektin fizik dhe bakteriologjik është i pijshëm. Sipas mjekëve, në Qendrën për shëndet publik në Tetovë, edhe analizat shtesë të bëra tregojnë se uji është i sigurt për pije në Tetovë.

"Nëse kemi informata se uji është i sigurt dhe

nuk ka erë dhe shijë të mirë, atëherë mundet edhe të mos e konsumoni dhe të shfrytëzoni ujë të ambalazhuar, por ka edhe të atillë që nuk e ndjejnë ndryshimin e shijes dhe e konsumojnë", thotë Ratko Davidovski, mjek.

Ai apelon që NPK-ja në Tetovë të ndërmer masa

shtesë dhe serioze që të zbulojë se çka e ka shkakton ndryshimin e shijes së ujit. Nëse ekzistojnë dyshime se ka ndryshuar shija e ujit nga këto që themi, atëherë ekziston metodë ku mund të largohet kjo që është shkaktuar dhe uji të kthehet në normalitet. Ai dyshon se ndryshimet në shijen dhe erës së ujit vjen nga lëshimi i ujit në ujësjellësin e ri, i cili furnizohet nga ujërat në Malin Sharr.

"Nga përvoja jonë mund të them se ndryshimi ka ardhur si pasojë e lëshimit të ujit nga lumenjtë në Leshnicë dhe Lumi Shkumbin në ujësjellësin e ri. Ky ujë përmes stacionit të filtrimit kyçet në ujësjellës. Mendimi ynë është se do të duhen të bëhen analiza shtesë të pranisë së algave, apo gjallesave tjera, por në këtë kohë ka edhe rënie të gjetheve, të cilët ne dyshojmë se mund të shkaktojnë ndryshimin e shijes dhe erës së ujit", thotë mjeku Ratko Davidovski.

Ndërkaq, një ditë më parë me komunikatë, pas

heshtjes së gjatë, ka dalë edhe Ndërmarrja Publike Komunale Tetova-Tetovë.

"Sipas rezultateve nga analizat e kryera nga Instituti për shëndet publik -Shkup, ju njoftojmë se uji nga ujësjellësi i qytetit të Tetovës është sipas kushteve të parapara me Rregulloren për sigurinë e ujit për pije (Gazeta Zyrtare e RM-së nr.46/08). Uji po ashtu është i pastër sa i përket gjendjes së tij mikro-biologjike, kimike dhe fizike dhe është i sigurt për pije", njoftojnë nga NPK-ja.

Përndryshe, tetovarët furnizohen me dekada të tëra me ujë nga Mali Sharr, i cili edhe pse nuk ka qenë i mjaftueshëm për nevojat e tetovarëve, megjithatë ka qenë i pastër. Para një muaji kur u lëshua në përdorim ujësjellësi i ri, i cili me ujë furnizohet nga Lumi Shkumbin dhe Leshnicë, me ç' rast qyteti ka edhe 200 litra ujë shtesë, megjithatë pas normalizimit të gjendjes me ujin, tetovarët tashmë përballen me këtë dukuri.

Kur kohët ndryshojnë

Ujë ka, cilësi s'ka

Zhelina dhe Vrapçishti me kryetarë të rinj

Tetovë, 3 nëntor - Në Komunën e Vrapçishtit zyrtarisht është bërë pranimi dorëzimi i postit të kryetarit të komunës. Kësisoj, Isen Shabani, kandidati i Aleancës për Shqiptarët, prej të premtes është edhe zyrtarisht kryetar i Komunës së Vrapçishtit. Këtë post deri më tani e ka mbajtur Bajram Kadrija nga Bashkimi Demokratik për Integrim. Isen Shabani si kandidat i Aleancës për Shqiptarët në zgjedhjet e 29 tetorit mori 5642 vota, kundrejt Gajur Rushitit të BDI-së, që mori 5184 vota. Po ashtu Komisioni Komunal Zgjedhor në Vrapçisht, ka ndarë certifikata edhe për këshilltarët e rinj në këtë komunë. Sipas rezultateve përfundimtare, në përbërjen e ardhshme të këshillit të Vrapçishtit, BDI-ja ka 7 vende të këshilltarëve, Aleanca për Shqiptarët ka 6 këshilltarë, Partia Demokratike e Turqve ka 3 këshilltarë, Lëvizja Besa dy këshilltarë dhe LSDM-ja një këshilltar.

Në Komunën e Zhelinës zyrtarisht është bërë pranimi dorëzimi i postit të kryetarit të komunës. Me këtë rast Blerim Sejdiu nga Lëvizja Besa, gjithashtu prej të premtes do të jetë kryetar Komune në Zhelinë, detyrë këtë që e ka ushtruar deri më tani Fatmir Izairi nga BDI-ja që ishte edhe kandidat në zgjedhjet e fundit lokale të mbajtura më 29 tetor. Blerim Sejdiu nga Lëvizja Besa në raundin e dytë mori 5.443 vota, kurse Fatmir Izairi nga BDI-ja 5.099. Po ashtu Komisioni Komunal Zgjedhor në Zhelinë, ka ndarë certifikata edhe për këshilltarët e rinj në këtë komunë. Sipas rezultateve përfundimtare, në përbërjen e ardhshme të këshillit të Zhelinës, BDI-ja ka 8 vende të këshilltarëve, Aleanca për Shqiptarët ka 1, Lëvizja Besa 9 dhe PDSH-ja 1 këshilltar.

(U.H.)

Ambasadori Timonie prezantoi Raportin e Akademisë për gjykatës dhe prokurorë Përforcimi i shtetit juridik, kusht për integrimin në BE

Ambasadori francez, Timonie, potencoi se në raport janë theksuar disa mendime lidhur me edukimin e vazhdueshëm të gjykatësve si dhe formimin e Inspektoratit të përgjithshëm për jurisprudencë

Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 3 nëntor - Maqedonia në të ardhmen sa i përket reformave në gjyqësor, do të duhet të përmirësojë përfundimisht adekuat të etniteteve tjera në Akademinë e Gjykatësve dhe Prokurorëve në Maqedoni, në bazë të kriterëve për selektimin e kandidatëve më të mirë. Kështu u shpreh ambasadori francez në Maqedoni, Kristian Timonie, para se t'i dorëzon ministrit të Drejtësisë, Bilent Saliji, Raportin për përvojën dhjetëvjeçare nga bashkëpunimi me Akademinë e Gjykatësve dhe prokurorëve publik dhe Akademisë nacionale franceze për jurisprudencë (ENM) në sferën e reformave në gjyqësi.

"Akademia për gjykatës dhe prokurorë publik dhe Akademia nacionale franceze për jurisprudencë (ENM) bashkëpunojnë tashmë 10 vite. Ky bashkëpunim realizohet përmes pasurimit dhe përmirësimit të praktikave gjyqësore, përmes këmbimit të përvojave të gjykatësve nga Franca dhe nga Maqedonia. Integrimi evropian i Maqedonisë është kushtëzuar me përforcimin e shtetit juridik, që nënkupton vendosjen e sistemit të trajnimit dhe zgjedhjes së gjykatësve, të cilët i përmbushin kriteret objektive dhe të unifikuara", deklaroi ambasador francez, Timonie. Njëherit ambasadori francez, Timonie, potencoi se në raport janë theksuar disa mendime lidhur me edukimin e vazhdueshëm të gjykatësve si dhe formimin e Inspektoratit të përgjithshëm për jurisprudencë.



"Me përvojën e saj 10 vjeçare Akademia, përveç që u sfidua me shumë probleme, njëherit tregoi se Akademia e gjykatësve dhe prokurorëve është vegël e rëndësishme për përparimin e Maqedonisë drejt integriteteve evropiane dhe integriteteve tjera që Maqedonia po pretendon", tha ambasadori Timonie. Raporti në fjalë, tha Timonie, është analiza e deritanishme për përvojën dhjetëvjeçare dhe disa

rekomandime se si të konfirmohen drejtimit për bashkëpunim të ardhshëm, i cili do të kontribuojë për mendim të pasuruar në kuadër të agjendës reformuese të miratuar nga Qeveria e re.

"Qëllimi i këtij raporti dhe i Akademisë nacionale franceze, nuk është që Akademia e gjykatësve dhe prokurorëve në Maqedoni të kopjon punën se si punojnë gjyqtarët dhe prokurorët në Francë, sepse Maqedonia nuk është Francë, mirëpo mund të gjejnë ide të reja nga sistemi ynë gjyqësor dhe të mos ketë keqpërdorime nga ana e gjykatësve, siç janë kritikata e shumta se Qeveria e mëparshme ka pasur kontroll të plotë ndaj sistemit gjyqësor në Maqedoni. Tani Qeveria e re po punon shumë mirë në realizimin reformave gjyqësore, në pajtim të rekomandimeve të Pribes", tha Timonie. Ministri i Drejtësisë, Bilent Saliji, raportin e

Akademisë nacionale franceze për jurisprudencë (ENM) e vlerësoi si shumë të rëndësishëm, i cili njëherit mund të jetë udhërrëfyes për zbatimin e reformave në gjyqësi si dhe për përgatitjen e strategjisë se re sipas Planit aksionar të qeverisë 3,6,9 për reformat në sektorin e jurisprudencës. "Menjëherë pasi të miratohet strategjia e re nga Qeveria e Maqedonisë në bazë të afateve kohore, do të fillojmë më përpilimin e ligjeve në sferën e gjyqësorit dhe njëri nga këto është dhe Ligji për Akademinë e gjykatësve dhe prokurorëve kohore. Pikërisht ky raport që m'u dorëzua nga ambasadori i Francës, do të shërbejë që t'i eliminojmë të gjitha dobësitë që kishte ligji i mëparshëm dhe më tejkalimin e këtyre mangësive, jam më se bindur se Akademia e gjykatësve dhe prokurorëve në të ardhmen do të ketë funksionim më cilësor", tha ministri i Drejtësisë, Bilent Saliji.



Dokumente

Letra e panjohur e Çerçiz Topullit

(Drejtuar bashkatdhetarëve të tij, janar 1908)

E ndershmja gazetë "Drita", sikundër edhe gazetë shqipe, e kanë treguar kthjellët programin e Komitetit të komitave shqiptarë, andaj gjithë veprat tona të motit që shkoi ishin pas urdhërit të komitetit, në të përhapurit e ndjenjave kombëtare mbi gjithë anët të Shqipërisë, të cilat për gëzim të mëmëdhetarëve, e për nakar të armiqve, kanë përparuar shumë dhe rrënjësor në çdo zemër shqiptari. Sa për gjakun e Spiro Kosturit, pa fjalë që e kërkojmë dhe do ta marrëm siç duhet nga të vërtetët shkaktarë e jo siç pandehin edhe thonë grekët nga dhespotlerët që ndodhen në Shqipëri.

Dhespotlerët e gjithë krerët e çdo feje nderohen prej shqiptarëve dhe kurdoherë do t'i nderojmë dhe do t'i mbrojmë, po vetëm u lutemi të mos nakatosen në çështjet kombiare e të bëjnë propagandë për Greqinë, Turqinë e për të tjer-

at. Për vrasjen e Fotit, është i ditur shkaku, andaj mos pandehin grekët që programi i Komitetit është për të vrasur dhespotlerë, se ashtu më 24 orë këmbë nuk mbetet. Dy-tri herë i patëm në dorë dhespotin e Korçës e atë të Konicës, po as ndër mend nuk na shkoi një punë e tillë.

Despotit të Konicës nuk është e vërtetë që ju bë pusi, këto janë gënjeshtër të pakripura të grekëve e vetëm kur të vërtetohej një lajm që na dhanë për vrasjen e Riza beut, mund ta dridhte bishtin si Foti, po si u siguroam që s'ka gisht, asnjë frikë të mos ketë nga komitat shqiptarë.

Sa për vrasje të pafajme, siç bëjnë ruftanët grekë mbi gra e fëmijë, është jashtë programit tënë, se asisoj mund të vrasim në çdo ditë nga 100 grekë, që ndodhen në Shqipëri, po këta i numërojmë vëllezër pa ndonjë ndryshim, se edhe

këta as emrin s'duan t'i dëgjojnë Greqisë e s'mund të ndahen prej nesh. Shpresojmë që këtë verë të dëgjoen dhe nga këta të bashkëpunojnë nën flamur të komitetit shqiptar edhe atëhere do të mos mundin të thonë grekët asgjë. Grekët e dinë fort mirë që në Shqipëri nuk ka përveç shqiptarë, sa për fetë e kuptuan që shqiptari i nderon të gjitha, po më shumë Shqipërinë edhe bashkë: muhamedane, ortodoksë e katolikë përpiqen për qëllimin e shenjtëruar. Kjo duket që i mahnit grekët kur shohin që komitat janë prej gjithë feve.

Sa për të fëlliqurit turkomanë e grekomanë këta numërohen me gisht dhe vetëm interesat e poshtira i mbajnë larg qëllimit. Po sa para u bën lëkura këtyre gomarëve të zgjebosur? Për këta tradhtarë e këpucëgrisor nuk ka tjetër përveç shpëtim të tradhtisë. Motin që shkoi nuk u përpoqem dot

me andartët, me gjithë të ndjekurat që bëjnë në ato vende ku kishin shëtitur përpara.

Vetëm 4 komita nga Devolli u përpoqën me 35 andartë nga të cilët u vranë dy. Këtë mot, shpresojmë të mos dëgjoet as emër andarti grek në Shqipëri. Moti 1908 do të jetë i lumtur për Shqipërinë, andaj besojmë se është e teprt t'u kujtojmë detyrën që kanë mëmëdhetarët për të mbushur, se dita për dita ushtëria shtohet dhe duhet ndihmuar Komiteti për qëllimin e shenjtëruar.

Edhe me qenë fjala për detyrë, duhet përmendur shqiptarëve të brendshëm që nuk bëjnë përveç detyrën duke pritur komitat nëpër shtëpit dhe jo të pandehin që e bëjnë këtë miqësisht. Po për fat të keq ndodhet, edhe gjer më sot, nga ndonjë shqiptar i çnderuar i cili, duke pritur komitat në shtëpi, shpreson t'i shpien ndonjë gjë të vjedhur. Shkoi ajo



kohë dhe është turp i madh të ushqejnë të këtila qëllime, andaj i këshillojmë të heqën dorë se komiteti kusarët do t'i ndjekë gjithë si tradhtarët.

Sot është koha t'i tregojmë gjithë botës së qytetëruar që shqiptarët janë ata më të mirët njerz dhe i meritojnë të drejtat

që kërkojnë, andaj lini mënjane gjakrat, meritë e kusarllëqet dhe rrethohuni flamurit të nderuar për shpëtim të mëmëdheut. Ju lutemi pritni nderë që ju ruajmë.

Shërbëtori i Kombit.
Kryekomit Çerçiz Topulli
(gazeta-shqip)

Elbasan

Rrobaqepësia e parë e komunizmit

Kjo ishte pjesa më e rëndësishme e qytetit dhe vendi më i përzgjedhuri, para kalasë së qytetit. Në vitin 1960 një rrobaqepësi ishte gjithçka pasi rroba të gatshme kishte pak, thuhajse aspak. Një grup mjeshtrash të prerjes së qepjes së veshjeve ka dalë në një fotografi duke na dhënë një imazh të asaj kohe, ku parrullat e Enverit duken në sfond. ADE ka publikuar fotografinë e siguruar nga

familja Trëndafil në Elbasan ku nga e majta janë: 1. Daut Duhaxhiu, 2. Josif Shuteriqi, 3. Kostandin Miraku (çirak), 4. Ilija Trëndafil, 5. Agron Tafa. Nëse shikoni me vëmendje fotografinë vë re se në vitrina nuk ka reklama pa parulla të partisë komuniste në planet e 5-vjeçarit si dhe begatinë e 15 viteve diktaturë. Kjo rrobaqepësi ndodhej në pazarin e Bezistanit i shembur pak vite më vonë.



Financial Times magjepset pas muzikës popullore shqiptare

Bluzi ballkanik!



Financial Times e Londrës përmes një artikulli për turneun britanik të ansambllit shqiptar të muzikës tradicionale "Saz'iso", që fillon në 1-11 nëntor nëpër disa qytete britanike, reklamon fuqishëm muzikën popullore shqiptare.

Në shkrimin me titullin "I hipnotizuar nga tingujt e Bluzit ballkanik", gazeta e madhe britanike Financial Times, duke shkruara për gazetë shqiptare thekson se ato "janë hipnotike dhe shpirtërore, siç është vetë Shqipëria".

Producenti i grupit Joe Boyd shprehet se "Shqipëria është e jashtëzakonshme. Herën e parë që e vizitova për

të marrë pjesë në festivalin e Gjirokastrës, nuk e kisha idenë se çfarë më priste. Ajo që zbulova ishin njerz miqësor dhe një skenë mbresëlënëse e muzikës tradicionale".

Ansamblit "Saz'iso", prej 9 instrumentistësh dhe këngëtarësh, i krijuar nga producenti i njohur, 70 vjeçari, Joe Boyd, i cili ka bashkëpunuar dikur edhe me Pink Floyd, do të jetë grupi i parë muzikor shqiptar, që do të zhvillojë një turne zyrtar në Britani.

Turneu që fillon më 1 nëntor dhe përfundon më 11 nëntor, do të nisë nga Kardifi në Uells për të vazhduar në Cambridge, Bristol, York,

Sheffield e deri në Londër, ku për shfaqjen e Londrës në të famshmen, qendrën e shfaqjeve, Barbican janë shitur të gjitha biletat.

Producenti Boyd bashkë me bashkëshorten e tij Andrea Goertler, e cila jeton tashmë në Shqipëri thonë se "audiencia britanike do të përjetojë një argëtim realisht ekzotik".

Ata shpresojnë se turneu i "Saz'iso", "do të ndihmojë që t'i hapi sytë e publikut britanik ndaj bukurisë së Kulturës Folklorike të Shqipërisë". Reklamë këtij turneu muzikor shqiptar që fillon të martën i ka bërë edhe The Guardian e Londrës.



Reportazhi



Një shteg ecjeje mes Shqipërisë, Malit të Zi dhe Kosovës

Është një emër ndjellës, por që nuk arrin të përshtatet me zonën, pasi është një vend spektakolar me majat gëlqerore

Rudolf ABRAHAM

Unë po ecja përgjatë luginës Ropojana, në Prokletije, në të ashtuquajturat "Malet e Mallkuara", të cilat përbëjnë kufijtë e thyer mes Malit të Zi, Shqipërisë dhe Kosovës. Është një emër ndjellës, por që nuk arrin të përshtatet me zonën, pasi është një vend spektakolar me majat gëlqerore, kullota të gjelbërta, kalime të larta dhe fshatra malorë mikpritës.

Gjurma që ndjek është Maja e Ballkanit, një udhëtim epik, 120 milje nëpër disa nga peizazhet më të bukura që ky kënd i Evropës ka për të ofruar. Një rrugë rrethore që



pothuajse bashkohet në mes si numri tetë, zgjat rreth 10 ditë duke ecur, akomodim dhe ushqim të siguruar nga banorët e fshatrave. Në krye të luginës kaloj shtratin e një liqeni të zbrazët, të ushqyer vetëm nga shkrija e botes.

Lë Malin e Zi dhe kaloj kufirin e pashënuar në Shqipëri, duke ndjekur

një rrugë deri në pyll, pastaj pranë një luginë të ngushtë. Gjurmët kalojnë pranë disa bunkerëve të ngjashëm me kupola, gati gjysmë milioni të tillë të ndërtuar nga diktatori shqiptar Enver Hoxha në të gjithë vendin midis viteve '68.

Katër orë pas daljes nga luginja e Ropojanës së Malit të Zi, arrita në lug-

inën e Pejës në 1,707 metra lartësi, me pamje nga Lugina e Thethit. Sapo ka filluar mbrëmja kur shkoj në fshatin e largët të Thethit, të shpërndarë përgjatë luginës së luginës pranë lumit dhe gjej rrugën për në bujtinën miqësore 'Polia'. Ndërkohë, ka diçka shumë të kënaqshme në kompletimin e një rruge me distancë të



gjatë, siç janë Majat e Ballkanit, nuk keni nevojë të ecni në gjithë gjatësinë, sepse disa pjesë mund të bëhen si shëtitje ditore.

Këto janë tre rrugët më të mira:

Nga Plava (Mali i Zi), ndiqni rrugën kryesore përmes Thethit, Valbonës dhe Dobërdollit në Shqipëri, por kthehuni në veri në kalimin e Zavojit dhe zbritni në Babino Poljem dhe Plavë në Mal të Zi. Duke filluar në Vusanje (Mal të Zi), ngjitni Luginën e Ropojanës dhe mbi kalimin e Pejës, në Theth

(Shqipëri). Kaloni Kalanë e Valbonës në Valbona, pastaj për në Kalimin Prosllopit pranë Majës Kolata, prej këtu, ju mund të zbrisni në Vusanje. (Lapsi.al)

Ujëvarë Theth dhe Kulla: Për Thethin duhet një ditë më vete. Nga kisha e shekullit të 19-të kalojmë kullën e shekullit të 17-të (Kulla), pastaj kalojmë urën dhe ndjekim bregun e majtë të Thethit para se të ecim deri në ujëvarën e Gunas, e cila zhytet 30 metra mbi një shkëmb në një pishinë të gjelbëruar.

Fotografi të veçanta

Pajtimi i gjaqeve

Në fotografi shihen prijës fetarë, kreu i këtij aksioni, Anton Çetta, shkrimtari i njohur Ramiz Kelmendi, Akademik Mark Krasniqi, dhe pleqnari nga Drenica Mujë Loshi.

Më 2 shkurt 1990 me nismën e Anton Çetës nisi në Kosovë aksioni atdhetar e humanitar i faljes së gjaqeve, që mori përmasa të gjera, duke u përhapur anembanë vendit.

Ky konsiderohet edhe si viti më i organizuar dhe më frytdhënës i kombit shqiptar që hyri në his-



tori si viti i bashkimit e i pajtimit të popullit shqiptar kudo që jetonte, brenda trojeve etnike dhe

mërgatë. Nuk kishte kaluar shumë kohë nga formimi i Lëvizjes Gjithëkom-

bëtare si përgjigje Millosheviqit për vetë emërimin si kral i të gjithë serbëve në Fushë Kosovë, mbylljes së shkollave, helmimit, mbylljen e universitetit, gazetave e mjeteve tjera të informimit, zgjimi i vetëdijes kombëtare ishte i paevitueshëm.

Kjo lëvizje u emërua si Lidhja Demokratike e Kosovës dhe së Kryetar u zgjodh dr. Ibrahim Rugova. Rugova kishte pranë vetes edhe njerëz të njohur si atdhetar. Askush nuk luftonte për bajraktarizëm por për atdheun.




FJALËKRYQI KLASIK



HORIZONTALISHT

- 3. Bashkë
- 5. Qytet në Tajlandë
- 7. Pranverë
- 9. Element kimik (Cr)
- 10. Dokument jo orgjinal
- 12. Element kimik (Cl)
- 13. Radiumi
- 14. Burrat që i kanë gratë motra
- 18. Posedon
- 20. Ngjyrë e lëkurës
- 21. Perëndia egjiptase, Amon
- 22. New Zealand
- 24. Kërçova
- 25. Qilim
- 27. Radoni
- 28. Tufë e madhe bagëtish
- 29. Ish atlet i Marokut
- 32. Shkollë (arab.)
- 33. Kryeqyteti i Perusë
- 35. Peksimadhja
- 37. Fillimi i agimit
- 39. Aktorja angleze Kensit
- 40. Jo i moshuar
- 41. Pjesë e molekulës
- 42. Lloj krimbi i drurit
- 45. Industria kroate e naftës
- 46. Vatani, vendi
- 49. Mizor
- 50. I papastër.




VERTIKALISHT


- 1. Që ka të bëjë me kohën
- 2. Paraardhës të Zelandës së Re
- 3. Jo çift
- 4. Mbulesë
- 5. Film i Isa Qoses
- 6. Përemër pronor
- 8. Inicialet e atdhetarit Jashari
- 9. Instrument muzikor
- 11. Inicialet e prozatorit Basha
- 12. Dy bashkëtingëllore
- 15. Astatit
- 17. Ankona
- 19. Sëmundje infektive, plasja
- 23. E kundërta e Nadirit
- 24. Fëmija mashkull i lindur jashtë martese
- 26. Futbollisti senegalian, Musa
- 29. Gjinia
- 30. Kau
- 31. Familja italiane e ndërtimit të violinave
- 32. Njësia e gjatësisë
- 34. Gjendje e njeriut në çastet e fundit të jetës
- 35. Aktori amerikan, Gregori
- 36. Titani
- 38. Aktorja amerikane Thurman
- 43. Kockë
- 44. Autori Mehmeti
- 47. Lloj, markë
- 48. Pjatë e thellë.

Kakuro


e lehtë



mesatare



e vështirë



KOHA e lirë

për më të rinjtë

TETËKAHËSHI-ndërtimtaria

Në tetëkahësh janë dhënë 21 shprehje që kanë të bëjnë me ndërtimtari (disa janë dhënë me figura). Në fund do t'ju mbeten 7 shkronja, të cilat lexuar me radhë e japin material ndërtimor.

P	T	A	L	E	B	I	L	I	M	
R	Ë	U	S	M	E	N	E	M	J	
O	C	J	I	A	T	O	V	I	E	
J	U	I	T	K	O	I	A	T	SH	
E	P	M	A	A	N	S	J	A	T	
K	Ë	I	I	R	R	I	K	O	Z	R
T	K	T	R	O	E	U	T	I	I	
I	Ç	A	T	C	R	R	N	V	RR	
M	I	V	S	A	A	T	E	H	A	
I	Z	U	I	E	C	S	M	E	F	
L	M	S	M	D	I	N	I	L	SH	
O	E	L	T	O	K	O	Ç	M	U	
Z	T	E	R	R	S	K	I	E	E	
I	R	O	T	Ë	N	U	P	T	S	
Q	E	R	E	S	T	E	J	A	I	

- | | |
|---------------|------------|
| IZOLIMI | PUNËTORI |
| KARROCA E | QERESTEJA |
| DORËS | SITA |
| KONSTRUKSIONI | SUVATIMI |
| LEVA | UJI |
| MISTRIA | VIZATIMI |
| MJESHTRI | ÇIMENTOJA |
| PROJEKTI | RRAFSHUESI |



H...M...



K...C...



S...C.



Ç...M...



L.B...



B...N....



K.RR... E D....

TRANSFORMIMI

Transformoni SOJËN në GUTI, duke e zëvendësuar nga një shkronjë me një tjetër.

1	S	O	J	A
2				
3				
4				
5	G	U	T	I



Shembull

Nga fjala e parë zëvendësoni një shkronjë me një tjetër dhe formoni fjalë tjetër.

Te shembulli i dhënë (SHKUP), fjala e dytë fitohet me zëvendësimin e shkronjës U me O dhe fitohet fjala SHKOP. Pastaj SH=A dhe fitohet fjala PAKO. Fjala SAKO fitohet me zëvendësimin P=S. Shkronja e mbetur K zëvendësohet me TH dhe fitohet fjala ATHOS, me çka realizohet procesi i transformimit.

1	SH	K	U	P
2	SH	K	O	P
3	P	A	K	O
4	S	A	K	O
5	A	TH	O	S



PLOTËSORI

HORIZONTALISHT:



- Paradhënie për të siguruar blerjen e diçkaje në bazë të një marrëveshjeje - Parakalimi i trupave ushtarake - Qytet në Turqi.
- Qytet në Algjeri - Kafshë (ang.) - Aksident, rast i pakëndshëm (fr.).
- Djemtë e djemve - Këpuçë për rrëshqitje në akull - Liqen në Finlandë.
- Çekiç - Qytet në Guine - E kërcënoj dikë me fjalë.
- Lëndë e tretshme në ujë që del nga bashkimi i kripës me acid - Lapsi - Modelistja Çunmulaj.

VERTIKALISHT (shih fotot):

- Këngëtare spanjolle, Buika (María Concepción Balboa).
- Personazh i Walt Disney-t (Sirena që shndërrohet në njeri).
- Perandori mizor romak (Claudius Caesar Augustus Germanicus).
- Këngëtare italiane (Rosalba Pippa).

Pyetjet e para vlejné deri te vija me pika, pyetjet e dyta brenda vijave të ndërprera, ndërsa të tretat nga vija me pika.

	1	2						3	4
1									
2									
3									
4									
5									



DALLIMET

Gjeni 20 dallimet në fotografitë e mëposhtme!



SUDOKU "killer"

Përdoren numrat prej 1 deri 9. Numrat e dhëna paraqesin shumën brenda sipërfaqes me vija të ndërprera.

7	2	29			9	20	7		12
		3	24		18	6			
7				2		9			
37	8		16		13	9	28		
8	7	18	12	7	13	13			
	22			8		20	6		
	6		9						1
9	5		11	1		12			

SUDOKU "më i madh se"

Përdoren numrat prej 1 deri 9. Vlejnë rregullat e sudokut. Shenja ">" paraqet relacionin "është më i madh se".

9							5		
		7							
	9						4		
			5			1			
			6		4				
8	4							6	

KENKEN

Përdoren numrat prej 1 deri 6. Numrat tregojnë rezultatin, ndërsa shenjat pranë numrit, operacionin matematikor.

21+			10+	2	13+	26+		8	11+
7								6	
			7		2+	9			
90+		5	100+		8	3+	21+		7
18+	8	1-	6			8-			1
2+	6	300+			6-	7+			
		6-	3+		3+	4-	40+		8
12+		4	3	2-	14+		10+	15+	
		4-		5	6-				6

KRIPTOGRAMI

Kriptogrami zgjidhet sipas rregullit "numri i njëjtë - shkronja e njëjtë". Në fushat e hijëzuara shënoni emrin dhe mbiemrin e aktorit dhe politikanit kosovar në foto.

1	2	3	4	4	5	6	7	8	9	10	11	5
12	5	10	1		13	7	14		6	14	1	15
7	16	5		17	18	6	19	20		7	6	1
14	1		1	21	5	1	16		3	16	19	14
5	14	5	22						6	9	23	5
4	5	13	16						22	6	9	16
5		16	14						16		24	4
	9	14	9						14	25		7
3	20	5	25						3	26	6	1
4	3	27	5						4	1	9	14
28		1	21						5	16	1	
14	3		5						16	1		10
5	22	1	6						3	14	29	1
9	6	14	1						16	5	1	16
13	9	1	13		30	5	13	2	3		10	5
1	28	13		31	7	13	5	4		8	1	6
29	1	18	5		2	1	6		32	9	28	1
3	14	1	11	5	9	13	1	29	5	21	9	13

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16
A	D	E	M	I	K	U	LL	O	V	C	ZH	N	R	P	T
17	18	19	20	21	22	23	24	25	26	27	28	29	30	31	32
Y	Ç	Ë	L	Z	S	RR	J	F	SH	G	B	L	XH	DH	GJ

GOLFI enigmatik

Në lojën e golfit fitues është lojtari i cili me më pak të goditura arrin ta fusë topin në gropëz. Edhe te golfi enigmatik, që të dilni fitues, duhet të tuboni sa më pak pikë.

Te GOLFI enigmatik

- nëse formoni fjalë me të gjitha shkronjat e dhëna - në tabelë shënoni 1 pikë;
- nëse formoni fjalë me një, dy apo tre shkronja më pak - në tabelë shënoni 2 pikë;
- nëse formoni fjalë prej pesë shkronjave - në tabelë shënoni 3 pikë;
- fjalët deri në katër shkronja nuk merren parasysh dhe në tabelë shënoni 5 pikë.

Shembull

SHEMBULL	SKATIPËL		PIKË
	Një goditje	PLASTIKË	
	Dy goditje	SPITAL	2
	Tre goditje	LAPSI	3
	Dështim	X	5

Një goditje = të gjitha shkronjat
Dy goditje = deri minus tre shkronja
Tre goditje = fjalë prej 5 shkronjave
Dështim = tre shkronja e më pak

	ALERLAPE						
1	Një goditje						
	Dy goditje						
	Tre goditje						
	GJETIDERNEI						
2	Një goditje						
	Dy goditje						
	Tre goditje						
	KAGATIRËM						
3	Një goditje						
	Dy goditje						
	Tre goditje						
	MORITASANT						
4	Një goditje						
	Dy goditje						
	Tre goditje						
	VËTISIRENT						
5	Një goditje						
	Dy goditje						
	Tre goditje						
PIKËT	TABELA	1	2	3	4	5	GJITHSEJ
	A						
	B						



ARUKONE

Bashkoni me vija numrat e njëjtë. Vijat nuk guxojnë të priten dhe duhet të përfshihen të gjitha fushat!

3			5			9
	6	8			1	
	8		4	7		
4						9
				2		2
	6		3		1	
			7			5

HITORI

Numrat që përsëriten duhet të nxihen, ashtu që në kolonat dhe rreshtet të mbeten numrat prej 1-9.

9	2	8	6	1	5	5	6	5
6	9	3	4	7	6	1	7	5
1	8	5	1	8	7	9	5	3
5	1	9	6	7	8	1	4	2
1	7	5	1	9	1	6	2	5
2	6	7	1	4	1	3	3	9
7	7	1	3	5	5	2	8	6
3	5	6	8	7	2	4	2	6
6	5	2	9	8	4	5	1	7

NONOGRAM

Nxini fushat sipas numrave të dhëna. Numrat me presje (rreshtet) dhe ato njëri nën tjetrin (kolonat), tregojnë se ka pauzë në mes të fushave të nxira.

		1	1	2	
	3	2	1	1	3
3					
1	2				
1	1				
2	1				
3					

Sudoku

i lehtë

1								3
			4	2		1		
	9	3		1	4			7
4	1		9		8	3		
3	8		2		7	6		
	5	7		4	6			
9		2		8				1
3	7							


mesatar

		2		5		3		
9	8							2
4	1						6	
			7	1				
6					9			7
	2		8					
	3					4		
					5	1		
			9					8

i vështirë

8	9							
	2		4		3	1		
6			5	9				
		8	4	6				
	4	2		1		6	8	
				3	5	4		
			7	9				8
	6	9		8			3	
							4	1

MENSUR MAMUTI	NJËRA NGA KOORDINATAT	NJË METAL RADIOAKTIV	HIT I S.F.	REVOLUCION-ARI FRANCEZ. KOMTI	ILAÇ, MEDIKAMENT	UDINE	SHIH FOTON	ITALI	KOHA E LIRË	THJERRËZ E LUGËT LLOJ KAPUÇI	K	NJË VEGËL MUZIKORE	TENISTI AMERIKAN, XHON
SERIAL ME S.F.									MENDJETRA-SHË, BUDALLA (shq.) MATEMAT. FRAN. DEKART				
NJËSI MË E MADHE USHTARAKE (shq.)								AKTORI ITALIAN, TONI (Elio Cesari) FILM I KURO-SAVAS					
POLITIKANI IZRAELIT JICAK						MASHKULLI I BRESHKËS, BRESHK QË I TAKON IMPRESIONIZMIT							
AKTORJA SPANJOLE SASTRE					BANORE E IRANIT IDHA PUTHJE								
SISTEMI I KONTROLLIT DHE KOMUNIKIMIT TE NJERIU													
AUSTRI		IPSILO USHTARAK ME GRADE (shq.)		PENSION PROTECTION FUND ROBERT REDFORD									
KOHA E LIRË	QË I TAKON ETRURISË UJI ME SHEQER												
PËLCAS, DAL JASHTË KUFIVË													
E PAPER-DORUR				INTER-SCHOOL OF ZANZIBAR I GDHENDUR, ISHTYPUR									
AKTORJA SHQIPTARE KOSTANI					I.U. DËSHMORI I UÇK-SË, SINANI (ra në Korab)								
QYTET NË ANGLI													
ENVER IDRIZI				FILM I PARË SHQIPTAR (1958) SARAJEVË									
TEMPO LLOJ ËMBËLSIRË GREKE		PËRMBLEDHJA E BUHARIUT VEND NË MAQEDONI											
T								PRONAR I NJË FERME XHAMI	F	TV KOMEDIA ME S.F. "QESH E..."	LLOJ I NSEKTI AZIA-TIK, SHKAKTAR I MALARIES	NJË TV ITALIAN	SHKRONJA E PARË
BALERINI SHQIPTAR, KLEDI	ANGSTREM AKTORI YNË KARAGA		PERSONAL RAPID TRANSIT ME NGJYRË SI GJAKU					PIKA E MESIT NJËRI NGA FRASHËRIT					
K					FUQIA, GJALLËRIA TRANSPORTATION IMPROV. BOARD								VEPRIMTARI ARTISTIKE
MONEDHE E VJETËR ARGJENDI APO ARI HIT I S.F.								QYTET NË SPANJE NATRIUM					
Q													RUMANI ZERO
MAQEDONI (shkurt.)				POLITIKANI TOPI									KËTË DITË



--	--	--	--	--	--	--

ZGJIDHJET

SKANDI 	KRIPTOGRAMI 	TRANSFORMIMI 	PLOTËSORI 	PËR MË TË RINJTË 	KAKURO 	FJALËKRYQI KLASIK
-------------------	------------------------	-------------------------	----------------------	-----------------------------	-------------------	------------------------------



Raporti konstaton se institucionet qendrore të Kosovës nuk janë të pajisura siç duhet për të parandaluar penetrimin hibrid rus nëpërmjet instrumenteve ekonomike dhe politike që synojnë të ndikojnë në politikën e saj në Kosovë

Gjermani kundër dëbimit të shqiptarit



Xhezon e kam punëtorin më të mirë



Xhezo Ajazaj, shqiptari 31 vjeçar, i ardhur në Gjermani tri vite më parë si refugjat, i shtron me pllaka tri banjo brenda një orari pune. "Ai është punëtori ynë më i mirë", thotë shefi i tij i punës, Martin Habeland, shkruan bild.de. Por, duket se nuk do të jetë gjatë. Ajazaj, së bashku me të shoqen, Artiolen dhe tri vajzat e vogla (8 vjeçe, 4 vjeçe dhe 8 muajshe) duhet të kthehet nga ka ardhur, në Shqipëri, transmeton Albinfo.ch. "Ne në vend punishte nuk arrijmë asesi të kuptojmë. Xhezo është një koleg i jashtëzakonshëm, gjithmonë i zellshëm dhe i përpiktë. Përse vallë të dëbohet pikërisht ai dhe jo ata të huaj që janë ndeshur me ligjin", thotë Habeland. Xhezo pra ka një punë të rregullt, Artiola planifikon të ndjekë një kualifikim profesional ndërsa fëmijët vijojnë shkollën ose kopshtin ndërsa gjermanishten e flasin më mirë se shqipen. Integrimi pra, plotësisht i suksesshëm e megjithatë është vendosur për dëbimin e tyre.



Hulumtimi konstaton se Kosova është e ekspozuar ndaj një fushate të gjerë ndikimi në rritje të ndërhyrjes ruse kundër modelit të shtet-ndërtimit perëndimor dhe vlerave të tij demokratike, veçanërisht që nga viti 2008

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) ka publikuar raportin gjithëpërfshirës që flet në lidhje me "Ndërhyrjen e Rusisë në Kosovë", duke shtruar edhe pyetjet "si dhe pse". Autori, Pëllumb Kallaba, sipas një hyrjeje përmbledhëse të publikuar për media nga QKSS, ka shpjeguar se raporti është hartuar me qëllim të ofrimit të një analize të thukët për një çështje të rëndësishme së veçantë për Kosovën, siç është prania ruse dhe ndikimi i saj për zhvillimet ndërkom-bëtare të vendit. Hulumtimi konstaton se Kosova është e ekspozuar ndaj një fushate të gjerë ndikimi në rritje të ndërhyrjes ruse kundër modelit të shtet-ndërtimit perëndimor dhe vlerave të tij demokratike, veçanërisht që nga viti 2008. Shumë instrumente subversive dhe joshtarake do të vazhdojnë të përdoren kundër karakterit multietnik të Kosovës, me qëllim që të krijohen pretekste për një shtet të dështuar si dhe të rritet separatizmi lokal brenda komunitetit serb në komunat veriore. Raporti synon të de-konstruktojë sjelljen e politikës së jashtme ruse në mënyrë kronologjike, sidomos që nga vizita e parë e Presidentit të Federatës Ruse, Vladimir Putin në Kosovë më 17 Qershor 2001 bërë kontingjent ushtarak rus.

Po ashtu, hapësirë të theksuar i është kushtuar vendimit për sanksione të Qeverisë të Kosovës ndaj Rusisë më 2014, vendim ky i pazhurnuar tutje në raport me harmonizimin e sanksioneve të BE-së dhe SHBA-së. Rrjedhimisht, sanksionet ndaj Rusisë nuk kanë rezultuar të jenë efektive pasi që subjektet ekonomike ruse të sanksionuara, por prezent në Serbi dhe rajon, kryesisht duke përfshirë produktet e naftës, vazhdojnë të funksionojnë ende në tregun e Kosovës. QKSS konstaton se Bashkimi Evropian nuk e ka trajtuar Kosovën në mënyrë të barabartë si vendet tjera të Ballkanit Perëndimor në pro-

Rusia sfidon orientimin pro-perëndimor të Kosovës



cesin e harmonizimit dhe vendosjes së sanksioneve ndaj subjekteve ekonomike dhe autoriteteve politike të Federatës Ruse. Po ashtu, gjatë periudhës janar-korrik 2017, niveli i mallrave ruse të importuara në Kosovë tejkalon shumë prej 10 milionë euro, ndërsa shifrat e eksportit të Kosovës drejt Rusisë mbeten zero. Kjo asimetri negative dëshmohet edhe në aspektin e hyrje/daljeve të qytetarëve rusë. Sipas hulumtimit, më shumë se 1000 qytetarë rusë vizitojnë Kosovën çdo vit, ndërsa qytetarët e Kosovës nuk mund të udhëtojnë në Rusi për shkak të refuzimit të menjëhershëm të pasaportave.

Raporti ka nënvizuar paradoksin që regjimi i vizave të Kosovës i privilegjon mbajtësit e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit rus nën kategorinë e veçantë të përjashtuar nga kërkesat për viza. Bartësve përkatës u lejohej të hyjnë, të kalojnë ose të qëndrojnë deri në 15 ditë në territorin e Kosovës. QKSS thekson se ky "lehtësim" përbën shqetësim të sigurisë nacionale për Kosovën prandaj një amendamentim i regjimit të vizave është i domosdoshëm. Ndërsa, numri i qytetarëve rusë që vizitojnë Kosovën rritet, roli aktual i Rusisë në Kosovë, përveç bllokadave në nivel ndërkom-bëtar, është treguar më së miri në kontekstin e komu-

nave veriore: lidhjet midis partive politike nga komuniteti serb dhe partia politike Rusia e Bashkuar e presidentit Putin janë vazhdimisht në zhvillim, ndërsa krijimi i Asociacionit të Komunave Serbe mund të paraqesë terren të ri për një angazhim më të fortë rus për të nxitur separatizmin lokal serb në Kosovë. Raporti ka theksuar se faktori fetar paraqet një element të rëndësishëm për ndikimin rus përmes Kishës Ortodokse Serbe. Me mbështetjen politike dhënë institucioneve fetare, Rusia kërkon të ruajë dhe të rrisë një prani të fortë emocionale në mesin e komunitetit serb në Kosovë. Mungesa e kontrollit të duhur financiar në raport me buxhetin e Kishës Ortodokse Serbe krijon mundësi për një agjendë përçarëse dhe një keqpërdorim potencial të këtij hendeku institucional, në interes të angazhimit të Rusisë dhe forcimit të ndikimit të tyre të mundshëm në Kosovë. Fabrikimi i lajmeve të pavërteta (fake news) përmes përfaqësive mediale ruse në Serbi dhe rajon në raport me Kosovën paraqet një sfidë të jashtëzakonshme ndërkom-bëtare. Raporti konstaton se një prani mediale pro-ruse në Serbi është një kartë e rëndësishme në përhapjen e propagandës midis serbëve të Kosovës, duke përfshirë Sputnik dhe Russia Today. Në anën tjetër, pozicioni i ash-

tuquajtur neutral i Serbisë ndaj anëtarësimit në NATO, së bashku me perceptimin negativ të publikut në Serbi për aleancën ushtarake perëndimore, mbetet një shqetësim serioz për perspektivën euroatlantike të Ballkanit Perëndimor. Operimi enigmatik i të ashtuquajturës Qendra Humanitare Ruso-Serbe me qendër në Nish nga viti 2011, krahas stërvitjeve ushtarake në rritje dhe investimeve midis dy vendeve, duhet të konsiderohet si një kërcënim afatgjatë i sigurisë jo vetëm për Kosovën por edhe për vendet fqinje.

Për fund, raporti konstaton se institucionet qendrore të Kosovës nuk janë të pajisura siç duhet për të parandaluar penetrimin hibrid rus nëpërmjet instrumenteve ekonomike dhe politike që synojnë të ndikojnë në politikën e saj në Kosovë, dhe për më tepër nuk ka vetëdije institucionale të mjaftueshme për të ndjekur dhe kuptuar interesat ruse në rajon. Kosova nuk ka strategji të qëndrueshme sesi të adresojë sfidat në raport me marrëdhëniet diplomatike bilaterale dhe multilaterale me Rusinë. Vlen të theksohet se raporti i QKSS ka adresuar një sërë rekomandimesh të përgjithshme të cilat duhet të trajtohen nga Qeveria e Kosovës, Bashkimi Evropian, shoqëria civile, media dhe komuniteti i biznesit.

Ministri italian i Policisë në Shqipëri: Të godasim të paprekshmit

Ministri i Brendshëm i Italisë, Marco Minniti zhvilloi ditën e sotme një vizitë zyrtare në Tiranë. Zyrtari i lartë u takua fillimisht me homologun e tij shqiptar Fatmir Xhafaj dhe më pas me Presidentin e Republikës Ilir Meta. Ndërkohë, Guardia di Finanza bëri me dije rezultatet e "Misionit të monitorimit ajror 2017 në luftën anti-kanabis". Raporti u publikua nga Stefano Skrepanti, shef i repartit të tretë të Guardia Di Finanza, i cili theksoi se veprimtari intensive ka çuar në një reduktim të kultivimit të kanabisit. "Këtë vit kemi pasur një rritje me

40% të shpërfaqjes së monitoruar krahasuar me një vit më parë. Është monitoruar 23.77% e sipërfaqes totale të Shqipërisë. Kjo veprimtari intensive ka çuar në një reduktim të kultivimit të kanabisit. Një bashkëpunim shumë i vlefshëm është ai me autoritetet shqiptare, të cilat na garantojnë një shkëmbim të përditshëm në tokë dhe në det", tha në fjalën e tij Skrepanti. Ndërkohë, ministri i Brendshëm i Italisë, Marco Minniti vlerësoi maksimalisht operacionet anti-kanabis, ndërsa tha se "duam të godasim organizatat e mëdha, duhet të godasim të paprekshmit,



pasi në Itali e Evropë nuk ka të paprekshëm". "Shpreh përgëzimet e mija për kolegun tim shqiptar, i cili ka organizuar një takim kaq të rëndësishëm, i cili sinjalizon shëndetin e shkëlqyeshëm të bashkëpunimit tonë. Një marrëdhënie

që ka lindur para shumë vitesh, ka parë të bëhen vetëm hapa para.

Sot na dorëzohet një bashkëpunim të rëndësishëm në fushën e sigurisë, kundër trafikëve të paligjshme dhe krimit të organizuar. Guardia Di

Finanza ka kryer një punë të jashtëzakonshme dhe për këtë e falënderoj. Bashkëpunimi ka çuar në rezultate të jashtëzakonshme. Ne kemi përballë një operacion të suksesshëm, që prej vitit 2013-2017 kemi parë një rritje progresive edhe të rezultateve dhe sido qoftë në momentin që theksojmë se kemi të bëjmë me operacion suksesi unë nënvizoj: Operacionet e suksesshme duken në kohë, këto rezultate duhet t'i mbajnë edhe në vitet e ardhshme. Në luftën kundër krimit të organizuar, në këtë objektiv strategjik do të keni ba-

shkëpunimin e plotë të qeverisë italiane. Ne duam të godasim organizatat e mëdha, duhet të godasim të paprekshmit, pasi në Itali e Evropë nuk ka të paprekshëm, për këtë objektiv duhet të punojmë së bashku. Në këtë projekt dhe objektiva është angazhuar i gjithë sistemi italian që kanë bashkëpunuar me Shqipërinë dhe këtë e tregojnë edhe të dhënat. Ky raport, kjo marrëdhënie përfshihet në një marrëdhënie edhe më të gjerë mes Shqipërisë, Evropës dhe vendeve të Ballkanit", tha ministri i Brendshëm i Italisë.



Ekonomia e Stambollit më e madhe sesa 130 vende të botës

Prefekti i Stambollit, Vasip Sahin, njëherësh president i Agjencisë për Zhvillimin e Stambollit (ISTKA), ka bërë me dije se metropoli më i madh turk, me një vëllim ekonomik prej 349 miliardë dollarësh, ka lënë pas 130 shtete të botës. "Si përfaqësues të ISTKA-së, ne jemi të mendimit se rëndësia e vendit tonë në mesin e vendeve të grupit me të ardhura të larta mund të arrihet nëpërmjet produkteve me vlerë të shtuar të lartë, prodhimi i të cilave do të arrihet vetëm me projekte të kërkim-zhvillimit dhe inovacionit", ka thënë Prefekti Sahin. Ai ka nënvizuar gjithashtu se Stambolli përfaqëson rreth 40 për qind të ekonomisë së Turqisë. "Me të ardhurat e prodhuara vetëm nga Stambolli, ky megaqytet lë pas 25 vende evropiane si Rumania, Hungaria, Kroacia dhe Luksemburgu duke zotëruar një fuqi ekonomike më të madhe sesa 130 shtete të botës", ka përfunduar kreu i ISTKA-së.

Kim urdhëron gratë: Bëhuni të bukura!



Të gjithë po flasin për bombat bërthamore. Megjithatë, diktatori i Koresë së Veriut, Kim Jong-un vizitoi një fabrikë kozmetike në vendin e tij. Godina sapo është rinovuar dhe 33-vjeçari kreu një inspektim në disa prej laboratorëve. Ai shoqërohej nga bashkëshortja, Ri Sol-ju, 28 vjeç, e cila nuk ishte parë në publik prej kohësh. Pasi vlerësoi punën dhe cilësinë e produkteve, diktatori u bëri thirrje grave të vendit të tij të bëhen më të bukura. "Jam i lumtur, që t'u them grave të vendit tim dhe vendeve të tjera, që tashmë kemi kozmetikë të klasit botëror nga Kореja e Veriut", tha ai.

"ALLAHU AKBAR", një frazë e përditshme që sulmet e njollosën

Mohamed Andeel, një karikaturist dhe shkrimtar egjiptian, pyet nëse ia vlen të përpiqet t'u mësojë jo-muslimanëve kuptimin e vërtetë të Allahu Akbar. "Nëse u thoni njerëzve që të mos kenë frikë nga diçka", thotë ai, "ata do të mësojnë të kenë frikë nga diçka tjetër"

Kur H. A. Hellyer shëtit me familjen e tij, të huajt ndonjëherë i afrohen atij dhe i thonë, "Allahu Akbar!". Shumë perëndimorë mund ta kenë të vështirë të besojnë këto kohë, por Hellyer nuk zbrapset nga frika. "Unë jam duke shëtitur me fëmijët e mi", thotë ai, "dhe dikush afrohet e thotë: 'Oh, janë kaq të bukur. Allahu Akbar'. Dhe unë i them me shaka: 'Faleminderit - tani mos fol më me fëmijët e mi'". Frazja arabe, që do të thotë thjesht "Perëndia është i madh", ndonjëherë duket të jetë ndërthurur me terrorizmin. Shoferi i një kamioni që mori përpara 20 vetë në një rrugë biçikletash në Manhattan të martën, thuhet se ka thirrur "Allahu Akbar!", para se të qëllohej nga një polici. Personat që kryen sulmin në gazetën franceze "Charlie Hebdo" në vitin 2015, thirrën këtë frazë gjatë sulmit. Dhe "Allahu Akbar!" jehoi në, ndërsa një ushtar britanik u u sulmuar pranë një kazermë ushtarake në vitin 2013, dhe më pas u ther e vdiq. Por për z. Hellyer dhe muslimanë të tjerë, Al-



lahu Akbar është një thënie kaq e zakonshme, saqë as nuk vihet re. "Është një shprehje krejt e parrezikshme", thotë ai. Origjina e saj është eksplicite fetare. Thuhet në thirrjen e falje, që dëgjohej pesë herë në ditë dhe në faljet që e pasojnë atë. Por dëgjohej edhe shumë larg nga xhamia. "Diçka e mirë do të ndodhë dhe njerëzit do të thonë, 'Urime' - dhe ata do të shpallin madhështinë e Perëndisë, si një mënyrë për të njohur atë që ata e shohin si bekim hyjnor", thotë z. Hellyer, një dijetar i fesë dhe politikës në Këshillin e Atlantikut, që jeton në Londër.

Përdorimi i saj mund të jetë edhe më pak i frymëzuar nga hyjnorja. "Le të themi se ekipi juaj i futbollit po kryen një sulm", thotë Ahdaf Soueif, një shkrimtar egjiptian. "Ju mund të thoni 'Allahu Akbar, Allahu Akbar, Allahu Akbar',

dhe kështu nxisni lojtarët: 'Shkoni shënoni, shkoni shënoni, shkoni shënoni'. Në mënyrë edhe më prozaike, thotë Soueif, "ju mund të shikoni një grua me të vërtetë të bukur, apo një djalë të pashëm, dhe të thoni 'Allahu Akbar'". Por fraza - për habinë, por edhe shqetësimin e myslimanëve - është përvetësuar edhe nga xhihadistët, të cilët pretendojnë se Islami justifikon sulmet e tyre mbi civilët e pafajshëm, në emër të Zotit.

Dhe në kohëra plot tension, vetë gjuha mund të shndërrohet në barrierë. Vitin e kaluar, për shembull, një student i Berkeley u dëbua nga një fluturim i Southwest Airlines pasi një pasagjer tjetër e dëgjoi atë duke folur në telefon, teksa i thoshte xhaxhait të tij se do ta telefononte kur të mbërrinte, "inshAllah". Kjo frazë do të thotë

"Dashtë Zoti" dhe - në Perëndim - përdoret gjerësisht në biseda. Dhe në vitin 1999, kur një avion i EgyptAir u përplas në mënyrë të pashpjegueshme në Oqeanin Atlantik, hetuesit amerikanë konkluduan se rrëzuar me dashje, sepse regjistruesi i zërit kapte një anëtar të ekuipazhit duke thënë: "Tavakilt ala Allah" - "Unë kam besim te Perëndia". Për veshët e hetuesve, fraza sugjeronte një qëllim të keq. Por për shumë muslimanë, ishte thjesht një njeri që pranonte fatin e tij. Megjithatë, kur është fjala për Allahu Akbar, nuk mohohet se kuptimi i saj, mund të varet nga kush e thotë. Soueif merr shembull përdorimin e shprehjes nga i dyshuari në sulmet e Manhattanit. Ai sugjeron se në fund të fundit, ajo ka pak kuptim real. "Njerëzit mund të lexojnë titujt rreth sulmit dhe thonë: 'Oh, ai tha Allahu Akbar, kështu që do të thotë diçka'", tha ai. "Epo, me siguri do të thotë se ai tipi po mendon që do të thotë diçka - por kjo nuk do të thotë që dikush që thotë 'Allahu Akbar' papritmas do të bëjë ndonjë veprim të dhunshëm. Larg qoftë". Mohamed Andeel, një karikaturist dhe shkrimtar egjiptian, pyet nëse ia vlen të përpiqet t'u mësojë jo-muslimanëve kuptimin e vërtetë të Allahu Akbar. "Nëse u thoni njerëzve që të mos kenë frikë nga diçka", thotë ai, "ata do të mësojnë të kenë frikë nga diçka tjetër". (The New York Times)

Në Gutën Lindore fëmijët kalojnë ditën me gjysmë vakti ushqimor

Mijëra familje në Gutën Lindore e cila ndodhet nën rrethimin e regjimit të Bashar al Asadit në Damask të Sirisë i dërgojnë fëmijët në shkollë të uritur. Babai i 6 fëmijëve Ibrahim Muhammed, tha se për shkak të papunësisë ai mund të sigurojë për fëmijët e tij vetëm gjysmë vakti të ushqimit në ditë. Ibrahim Muhammed, një nga mijëra baballarët që përpiqen të mbajnë familjet e tyre nën kthetrat e urisë dhe mungesës së ilaceve në Gutën Lindore, duke folur për Anadolu Agency (AA), rreth gjendjes në rajon, ka përdorur shprehjen



"përtej të keqes". Ai ka theksuar se për shkak të sulmeve të regjimit të Asadit nuk mund të gjejë punë në Gutën Lindore dhe se të gjithë shpresat i kanë tek organizatat e

ndihmave humanitare. Duke vënë në dukje se nga mëngjesi deri në darkë mund të ushqehen vetëm me një gjysmë vakti, Ibrahim tha se "2.5 vite më parë emigruam këtu duke u largua nga sulmet. Situata në Gutën Lindore është përtej të keqes. Papunësia është në masë të madhe. Për 6 fëmijët e mi nga mëngjesi deri në darkë mund të siguroj vetëm një gjysmë vakti ushqim. Situata jonë do të ishte edhe më keqe, edhe më e dhimbshme nëse nuk do të ishte prania e organizatave humanitare".

Merkeli përsëri gruaja më e fuqishme në botë

Vendin e parë në listë, Merkel e vulosi me fitoren e fundit në zgjedhjet federale në shtator të këtij viti, në të cilat siguroi mandatin e saj të katërt

Revista amerikane "Forbes" ka shpallur kancelaren gjermane Angela Merkel gruan më të fuqishme në botë për vitin 2017. Ky është viti i shtatë radhazi, që "Forbes" përzgjedh kancelaren gjermane për gruan më të fuqishme

në botë, nga gjithsej 12 përzgjedhje sa ka bërë deri më sot, shkruan "The Guardian". Vendin e parë në listë, Merkel e vulosi me fitoren e fundit në zgjedhjet federale në shtator të këtij viti, ku siguroi mandatin e saj të katërt. Vendi i dytë i ka takuar kryeministres britanike, Theresa May, përkundër një viti shumë të vështirë në të cilin partia e saj nuk arriti të marrë shumicën parlamentare në zgjedhjet të cilat u mbajtën në qershor.



Qasja e saj ndaj Brexitit, një proces që do të ketë pasojat afatgjata për Britaninë e Madhe dhe pjesën tjetër të Evropës, ka bërë që May përkundër brishtë-

sisë politike të mbetet njëra nga figurat politike botërore. E treta në listën me 100 gratë më të fuqishme në botë është filantropistja dhe afaristja

amerikane Melinda Gates. E katërta radhë Sheryl Sandberg, drejtore ekzekutive e Facebookut, ndërsa e pesta është drejtresha ekzekutive e General Motors, Mary Barra. Për herë të parë në listën e Forbes për 100 gratë më të fuqishme është radhë Ivanka Trump, e bija, njëherësh këshilltare e presidentit amerikan Donald Trump. Në konkurrencë ajo është renditur në vendin e 19-të, ndërsa për herë të parë, në këtë listë

ka hyrë edhe Nikki Haley, ambasadore e SHBA-ve në OKB (vendi 43), dhe aktori Priyanka Chopra (vendi i 97-të), aktualisht ambasadore e UNICEF-it e Vullnetit të Mirë. Ish-zonja e Parë amerikane, Michelle Obama, nuk është fare në këtë listë, pasi vitin e kaluar lëshoi Shtëpinë e Bardhë, ndërsa Hillary Clinton e cila në listën e Forbesit ka qenë e pranishme që nga viti 2004, ka rënë nga pozita e dytë, vitin e kaluar, në vendin e 65-të.



Liga e parë – java e 14

Shkëndijës s'i intereson seria e Rabotniçkit, paralajmëron fitore të re

Të dielën do të luhet java e 14-të në Ligën e parë futbolistike të Maqedonisë. Derbi i kësaj jave do të zhvillohet në stadiumin e qytetit në Tetovë, ku lideri aktual Shkëndija do të jetë nikoqiri i Rabotniçkit, skuadër e cila ka një seri prej tre fitoreve me radhë



Koha Bujar KURTAJ

Shkup, 3 nëntor – Futbollistët e Shkëndijës këtë sezon janë superior, ndërsa këtë e dëshmon edhe seria që kanë nga 13-të javët e parë, ku kuqezinjtë kryesojnë në renditjen tabelore me 31 pikë, respektivisht 10 fitore, një humbje dhe dy barazime. Favorit për tre pikët janë djemtë e trajnerit Qatip Osmanit, ndërsa ish-futbollisti i Rabotniçkit dhe tani i Shkëndijës, Bllagoja Todorovski thotë se tre pikët do të fitojnë ata, megjithëse ai pranon se nuk do të jetë lehtë. “Do të jetë një ndeshje e rëndë. E dimë se Rabotniçki tre përballjet e fundit i fitoi që dëshmon se është kundërshtar i mirë. Mirëpo, Shkëndija si gjithmonë do të synojë tre pikët. Luajmë para publikut tonë

dhe patjetër ti fitojmë tre pikët. Siç thashë nuk do të jetë lehtë, por shpresoj se do t'ia arrijmë qëllimit”, deklaroi për gazetën KOHA, Bllagoja Todorovski.

Derbi tjetër i kësaj jave do të zhvillohet në stadiumin në Çair, ku Shkupi do të pret Sileksin nga Kratova. Për Shkupin tre pikët nga kjo përballje janë të rëndësishme, andaj futbollistët e saj do të japin gjithçka nga vetja për të fituar ndeshjen. Përparësia për bardhekaltrit në këtë ndeshje do të jenë tifozët, të cilët do të jenë lojtari i 12-të, andaj lojtarëve nuk ju ngel asgjë tjetër, vetëm se tua kthejnë atyre me një paraqitje të mirë dhe fitore. Ndryshe, në ndeshjet e kaluara futbollist e Shkupit nuk kanë pasur fat, por ata shpresojnë që ndaj Sileksit të ndodh e

kundërta dhe pikët e humbura ti kompenzojnë në këtë përballje. “Kemi pasur kohë të mjaftueshme që të përgatitemi për duelin ndaj Sileksit dhe mendoj se jemi të gatshëm të dalim në këtë sfidë të përqendruar për të marrë pikë të plota. Në ndeshjen e fundit ishim të pafat duke humbur pikë me një gol në fund të pjesës së parë, por besoj se këtë të diel do të kompenzojmë atë me fitore. Gëzon fakti se ekipi është i kompletuar dhe të gjithë futbollistët konkurrojnë për 11-tshin e parë. Sileksi është kthyer në formë dhe ne nuk e nënvlerësojmë këtë fakt, por sigurisht se ne jemi shumë të motivuar pasi luajmë para publikut tonë, të cilët presin fitore”, u shpreh njëri prej futbollistëve më të mirë, Fisnik Zuka.

Akademia P. – Pobeda
Vardar – Skopje
Shkëndija – Rabotniçki
Pelisteri – Renova
Shkupi – Sileksi

Pas fitores së madhe ndaj Akademia Pandevit, Renova do të ketë një sfidë të vështirë. “Gjipspunuesit” do të jenë mysafir i Pelisterit në Manastir, skuadër e cila këtë sezon nuk po gëzon formë të mirë, ndërsa këtë e dëshmon edhe pozita në tabelën ku aktualisht me 12-të pikë mbajnë pozitën e 10-të. Ndërkohë, kampioni aktual Vardari në arenën “Filipi i dytë” do të pret “Skopjen”, kurse befasia e këtij sezoni Akademia Pandev do të jetë nikoqiri i Pobedës.

Të gjitha ndeshjet e javës së 14-të në LPFM do të zhvillohen të dielën në ora 13.30.

Bardhi flet për interesimin e PSZH dhe Interit

Shkup, 3 nëntor - I kanë mjaftuar vetëm 9 ndeshje dhe 4 gola në Primera Division për t'u vënë në qendër të vëmendjes së klubeve më të mëdha evropiane. Fjala është për Enis Bardhin, futbollistin shkupian, i cili është pjesë e Levantes në La Liga, pas transferimit nga Ujpeshti në Hungari. Paris Sen Zhermeni por edhe Interi, po vëzhgojnë ecurinë e 22-vjeçarit, që po tregon nga ndeshja në ndeshje rritje të performancës së tij. I pyetur nga mediat italiane për interesimin e Interit, Bardhi komentoi: “Për momentin jam i përqendruar të jap më të mirën për Levanten. Kam lexuar se Interi dhe PSZH më ndjekin, por kjo tani nuk ka fare rëndësi, sepse nuk jemi në periudhë merkatoje. Sigurisht që këto lajmë



janë interesante për mua, por jam i përqendruar te Levante. Më pëlqen shumë Premier Liga dhe besoj se mund të luaj në cilindo nga kampionatet më të forta në Evropë”, deklaroi Bardhi. Ndërkohë, ndeshjen e ardhshme Levante do ta luajë më 5 nëntor ndaj Gironës, ndërsa Bardhi pritet të jetë titullarë.

Pavarësisht humbjes nga Partizani

Skënderbeu ka gjasa për vendin e dytë



Humbja e pësuar në Beograd me 2:0 ka bërë që gjasat e Skënderbeut për të kaluar në fazën tjetër të zbehën ndjeshëm. Megjithatë, duke mbetur edhe dy sfida për t'u luajtur, Skënderbeu ka të drejtën që të nisë të bëjë llogaritë se si mund t'ia dalë. Mirëpo, në të gjitha rastet, nuk do të mjaftonte vetëm paraqitja e korçarëve, pa u kombinuar me sfidën tjetër të grupit. Duke qenë në kuotën e dy

pikëve, Skënderbeut i duhen dy fitore në rast se do të tentojë që të shpresojë kualifikimin. Në këto kushte, pra duke mundur Dinamon e Kievit dhe Jang Bojs në sfidat e kthimit, korçarët arrijnë në kuotën e tetë pikëve. Mirëpo, nevojitet edhe që Partizani i Beogradit, të mos marrë më shumë se dy barazime. Në këtë rast, Dinamo Kiev do të kryesonte grupin dhe Skënderbeu do të renditej e dyta me tetë pikë.

Strakosha: Jam lodhur duke pësuar gola çdo ndeshje

Edhe pse tashmë është një titullar i padiskutueshëm dhe këtë sezon Lacios i ka dhuruar disa fitore shumë të rëndësishme me pritjet e tij vendimtare, si ato në Torino dhe Xhenovë, Tomas Strakosha e ndien se mund të përmirësohet edhe më shumë. Në fitoren e tetë rresht kundër Nice, 22-vjeçari shqiptar

nuk u vendos asnjëherë në provë, duke ruajtur si rrallëherë të paprekur portën e Lacios dhe objektivi i tij është që të pësojë sa më pak. Në një intervistë dhënë përpara kësaj sfide, Strakosha u shfaq kritik me veten e tij, duke i habitur jo pak gazetarët italianë. “Objektivi im është që të mos pësoj gola, jam

lodhur duke e nxjerrë topin nga rrjeta pothuajse në çdo ndeshje. Duke llogaritur faktin se shënojmë shumë në çdo takim, nëse nuk pësoj, atëherë me 99 për qind i fitojmë ndeshjet”, – thekson portieri shqiptar që kërkon perfeksionin nga vetja. Në 11 ndeshje gjatë këtij sezoni në kampionat, Strakosha

është aktivizuar përherë titullar dhe ka pësuar 12 gola, 4 prej të cilëve në ndeshjen kundër Napolit, që është edhe humbja e vetme sezonale për skuadrën “bardhekaltrë”. Ndërkohë, në “Europa League” ai është aktivizuar në të katër ndeshjet dhe ka pësuar vetëm 3 gola.

Panuçi publikon listën për miqësoren me Turqinë

Rikthehet kumanovari Aliji, Ajdareviç prurje e re

Astrit Ajdareviç, Ylber Ramadani dhe Sabien Lilaj janë tre emrat e rinj të afruar në Kombëtare nga trajneri Kristian Panuçi. Risitë afrohen në repartin e mesfushës, me lojtarët që do të vendosen në dispozicion të trajnerit për miqësoren e 13 nëntorit me Turqinë. Mesfushori ofensivë, Ajdareviç, që militon te AEK-u i Athinës dhe me një të kaluar te Liverpooli në Angli dhe Standard Liezh në Belgjikë, u konfirmua si prurje e re te kuqezinjtë prej fundjavës së kaluar. Edhe grumbullimi i Lilajt nuk ishte surprizë, pas paraqitjeve mbresëlënëse të mesfushorit me Skënderbeun në kampionatin shqiptar,

por edhe në grupet e Liga Evropë. Po aq e merituar edhe ftesa për Ylber Ramadani, që po shkëlqen te Velje në Danimarkë, ndërsa prej kohësh është një prej elementëve më të rëndësishëm të përfaqësueses Shpresa. Mesfushori do t'i bashkohet ekipit vetëm tre ditë para ndeshjes, pasi më parë do të luajë në sfidën e 10 nëntorit, ku skuadra e Bushit luan në shtëpi ndaj Irlandës së Veriut. Në Kombëtare, trajneri Panuçi ka rikthyer edhe Naser Alijin. Mbrojtësi është ende pa skuadër dhe vazhdon të stërvitet te Bazeli, ndërsa në merkaton e janarit shpresohet që të nisë një aventurë të re, për t'u kon-



firmuar si një alternativë në krahun e majtë të mbrojtjes. Në këtë pozicion, kapiteni Ansi Agolli është lënë pushim prej angazhimeve të shumta, duke përfshirë edhe aktivizimin në Çampions. Në

krahasim nga grumbullimi i fundit, jashtë skuadrës kanë mbetur Hycion dhe Memolla në mbrojtje dhe Emanuele Ndoj në mesfushë. Në sulm mungojnë Bekim Balaj, që sapo është rikuperuar nga

lëndimi dhe ende nuk është në formë optimale, por edhe Sokol Cikalleshi, që vijon të jetë i dëmtuar. Për miqësoren e 13 nëntorit me Turqinë nuk ka ftesa për Keidi Baren e Atletiko Madrid dhe Enis Gavazajn të Skënderbeut, edhe pse u mendua që dy mesfushorët mund të kishin një shans për të treguar vlerat e tyre në skuadër. Shqipëria do të nisë grumbullimin të hënën, më datë 6, me futbollistët që do të paraqiten direkt në Antalia, menjëherë pas angazhimeve me klubet e tyre.

Lista: Portierë: Etrit Berisha (Atalanta), Tomas Strakosha (Lacio), Alban Hoxha (Partizani); Mbro-

jtës: Elseid Hysaj (Napoli), Ivan Balliu (Metz), Arlind Ajeti (Krotone), Mërgim Mavraj (Hamburg), Frederik Veseli (Empoli), Berat Gjimeshi (Benevento), Ermir Lenjani (Sion), Naser Aliji (pa ekip); Mesfushorë: Migjen Basha (Bari), Amir Abrashi (Fraiburg), Ylber Ramadani (Velje), Sabien Lilaj (Skënderbeu), Taulant Xhaka (Bazel), Andi Lila (Pas Janina), Astrit Ajdareviç (AEK Athinë), Odise Roshi (Akhmat Grozni), Ledian Memushaj (Benevento). Sulmues: Armando Sadiku (Legia V.), Eros Grezda (Osijek), Valon Ahmed (Maribor), Liridon Latifi (Pushkash Akademia), Azdren Llullaku (Tobol)



Tajson Fury paralajmëron Xhoshuan



Hamilton mund të thyejë rekordet e Shumaherit

Ka barazuar Sebastian Fettel, kaloi një legjendë si Ayrton Senna dhe, sipas drejtorit të garave të Formula 1, Ross Braun, në të ardhmen mund të kalojë edhe ikonën Mihael Shumaher. Piloti britanik Luis Hamilton siguroi ditën e diel titullin e katërt kampion bote në Formula 1, ndërkohë që në karrierë ka arritur 62 fitore dhe është ende shumë larg rekordit të 91 fitoreve që ka Mihael Shumaher. Por, për Braun kjo gjë është e mundur. "Mendoj se rekordet e Mihael janë të arritshme për Luis nëse do të ruajë këtë ritëm", tha Braun, që ka punuar me Shumaherin te Ferrari.

Hamilton ka ardhur te Mercedesi në vitin 2013, duke zënë pikërisht vendin e Shumaher dhe asokohe Braun ishte në detyrën e shefit të makinës gjermane. "Asokohe mendoja se askush nuk mund të barazonte rekordet e Mihael, por duke parë nivelet që ka arritur Hamilton, gjithçka mund të ndodhë. Në Meksikë ai pati një garë të vështirë, por ka qenë i jashtëzakonshëm gjatë sezonit", tha Ross Braun. Këtë vit, Hamilton vendosi rekordet e "pole position", 72 të tillë të arritura në karrierë, duke kaluar kuotën e 68 "pole" që kishte Shumaher.

Dueli me ty, sikur Muhamed Ali kundër Foreman

Kjo do të vijë. Kampioni i vjetër po kthehet të luftojë një njeri që të gjithë mendojnë se do të më nokautojë, njëjtë sikur Ali vs Foreman. Unë e di se të gjithë më shihni të humbur, por unë nuk do të zbrapsem e të kem frikë nga disa muskuj. Unë kam mentalitetin e një fituesi që kurrë s'ka humbur asnjë luftë", thotë Fury

deri tash në drejtim të Enthony Xhoshuas. Britaniku i cili pritet të kthehet në ring në vitin 2018 ndaj më të mëdhenjve të kategorisë së rëndë, ka krahasuar një duel të tij me Joshuan si duelin e Muhamed Alis me Xhorgj Foreman. Sipas Furyt, bota do t'i shohë duelet më të mëdha në histori të kategorinë e rëndë që ai do t'i zhvillojë kundër Xhoshuas dhe Vilderit.

Ndryshe, Josep Parkerin kampionin e VBO e konsideron si shumë të ri në këtë sport.

"Kjo do të vijë. Kampioni i vjetër po kthehet të

luftojë një njeri që të gjithë mendojnë se do të më nokautojë, njëjtë sikur Ali vs Foreman. Unë e di se të gjithë më shihni të humbur, por unë nuk do të zbrapsem e të kem frikë nga disa muskuj. Unë kam mentalitetin e një fituesi që kurrë s'ka humbur asnjë luftë", thotë Fury. "Një kampion i vërtet i cili po kthehet ta marrë kurorën e tij. Kjo është epoka ime dhe koha ime është tash që t'i shkatërroj ata. AJ dhe Vilder po vij për ju që të realizoj misionin e kërkimit dhe shkatërrimit, sepse gjithë ajo që kam në kokë

është shkatërrimi kush do që del para rrugës time. Ekziston vetëm një fitues dhe ata janë fansat. Le ta bëjmë kategorinë e rëndë të madhe sërish, të luftojnë më të mirët e divizionit. Unë e kam fatin tim në dorën time. Le të fitojë më i miri, le të fillojë festa. 2018 dhe 2019 bota do t'i shoh luftërat më të mira dhe do ta shohë mbretin e vërtet të kategorisë së rëndë sërish të stolisur me kurorën e tij", deklaroi Fury. Një duel mes Furyt dhe Xhoshuas mund të ndodhë në fillim të vitit 2018 nëse palët arrijnë marrëveshjen financiare.



Boksieri britanik, Tajson Fury, ka lansuar kërcënimin e tij më të madh

MekGregor i bindur

E mund Mejvederin në revansh

Kampioni irlandez i arteve marciale mikse Konor MekGregor ka deklaruar sot sërish se nëse do të zhvillonte revanshin me boksierin Floyd Mejveder do ta fitonte këtë sfidë të dytë mes tyre. Përballja e parë mes tyre zhvilluar më 26 gusht u fitua me "KO teknik" në raundin e dhjetë nga Mejveder, që korri suksesin e 50-të si profesionist dhe qëndroi i pamposhtur në karrierën e tij. Por MekGregor beson se nëse do të kishte një mundësi të dytë rezultati do të ishte ndryshe dhe



boksieri amerikan do të pësonte disfatën e parë, deklaratë që erdhi gjatë prezantimit të dokumen-

tarit "Notorius". Duke folur për "Sky News", sportisti irlandez tha. "Floyd e ndryshoi 3 herë

gjatë përballjes stilin e tij të të dueluarit. Herën e tretë përdori stilin meksikan, pasi dështoi në dy stilet e mëparshme ndaj meje. Stili i tretë më kapi në befasi, pasi ai asnjëherë nuk ka dueluar në atë mënyrë. Unë nuk isha përgatitur për atë stil boksimi. Për këtë arsye, e respektoj, por nëse do të përballeshim sërish në ring do ta mundja. Do të isha më i përgatitur", u shpreh Konor MekGregor, që pritet të rikthehet në kafaz për të mbrojtur titullin kampion të peshës së lehtë.

20 mijë firma për zëvendësimin e kësaj tabele



Një matematicien ka arritur të mbledhë mbi 20 000 firma në një petition që kërkon zëvendësimin e kësaj tabele, pasi sipas tij është një turp kombëtar. Britaniku Mat Parker i ka bërë thirrje qeverisë që të ndryshojë formën e topit në këto shenja që janë të shpërndara në të gjithë vendin, pasi topi i futbollit i vendosur në to është i pasaktë. Sipas tij, është matematicisht e pamundur që një top futbollit të formohet vetëm me heksagonë, por është një kombinim i këtyre të

fundit me pentagonë. Kjo logo është përdorur në Britani që prej vitit 1994 dhe Parker beson se ndryshimi i tabelave do t'i bëjë njerëzit të vlerësojnë më shumë gjeometrinë. Megjithatë, burime qeveritare janë përgjigjur se kosto e ndryshimit të tabelave në të gjithë vendin do të ishte shumë e madhe dhe ka pak gjasa që kërkesa e Parker të realizohet. Ai tani ka kohë deri në 6 prill 2018 për të mbledhur 100 000 firma, që nisma të diskutohet në Parlament.

NBA

Zhgenjejnë Lejkers

Dy ndeshje të luajtura mëngjesin e djeshëm në NBA, që kanë dhuruar spektakël e surpriza. Ka fituar skuadra kampione e Golden Stejt, që mundi 112-92 San Antonion. Një mbrëmje e mirë e skuadrës kampione, ku u dallua si zakonisht treshja Karry-Durant-Tompson, e cila realizoi 72 pikë. Për Spars një ndeshje të mirë bëri Aldridge, që realizoi 24 pikë e 10 kërcime, por i pa

mbështetur mirë nga pjesa tjetër e skuadrës. Humbet edhe ekipi i Lejkers, që u mundi 113-110 nga Portland, që para fansave të tij nuk zhgenjeu dhe arriti një fitore "in extremis". Lillard me 32 bika bëri diferencën në parket për Portland, mbështetur edhe nga Nurkiç me 28 e MekKolum me 22 pikë, ndërsa për kalifornianët nuk mjaftuan 27 pikët e Lopez dhe 22 të Kuzma.





Gjashtë ekipe në garë për titullin në Premier Ligë

“Çells i është kampioni në fuqi dhe një nga skuadrat më cilësore në vend. Unë i konsideroj ata, siç e konsiderojnë veten “Blues”, një konkurrent i madh për titullin. Unë mendoj se gjashtë ekipet e para konkurrojnë për titullin, ndërsa Everton, pavarësisht nga investimi i madh, nuk ka arritur të ndjekë grupin”, thotë Murinjo



Hoze Murinjo beson se gjashtë ekipe aktualisht janë të përfshira në garën e titullit të Premier Ligës, ndërkohë që Mançester Junajteti po përgatitet të përballet me Çellsin këtë të diel. “Djajtë e Kuq” janë për momentin të dytët në klasifikim, me 23 pikë, 5 pikë pas liderëve të Mançester Siti, ndërsa Tottenhami qëndron në

vendin e tretë me 20 pikë dhe Çells i katërti me 19 pikë. Arsenali është i nivelit në pikë me “Blues”, ndërsa Liverpooli i Jurgen Klopp është i gjashti, tre pikë prapa. Murinjo mendon se gara e titullit në Angli mbetet e hapur, pavarësisht dominimit të hershëm të “qytetarëve”. “Çells i është kampioni në fuqi dhe një nga skuadrat

më cilësore në vend. Unë i konsideroj ata, siç e konsiderojnë veten “Blues”, një konkurrent i madh për titullin”, – tha portugezi për “Sky Sports”. “Unë mendoj se gjashtë ekipet e para konkurrojnë për titullin, ndërsa Everton, pavarësisht nga investimi i madh, nuk ka arritur të ndjekë grupin. Nëse Liverpool është një pikë pra-

pa, unë jam goxha i sigurt se brenda dy javësh do të jetë pranë nesh”, nënvizoi më tej trajneri portugez. Ndërkohë, Mata dhe Matić do të kthehen në “Stamford Bridge” këtë fundjavë, ndërsa Murinjo mbetet i kënaqur që Mançesteri ka mundur të nënshkruajë me serbin në verë. Mesfushori ka impresionuar në “Old Trafford” që prej transferimit të tij prej 40 milionë sterlinash. “Isha i befasuar kur agjenti i Matićit më bëri thirrje, duke më thënë: a e doni atë? – shtoi Murinjo. – Unë kam qenë i befasuar, por ai është një agjent që unë e njoh mirë. Normalisht, ai është shumë i drejtpërdrejtë dhe objektiv, nuk humb kohën, nuk përpjet që njerëzit të jenë të interesuar për lojtarët e tij për të përmirësuar situatën në klubin e tyre”, përfundoi Murinjo.

Dëmtohet Lloris, humb derbit e Londrës



Tottenhami me shumë mundësi do të jetë pa kapitenin Hugo Lloris në dy derbit Londrës, duke përfshirë sfidën ndaj Arsenalit pas dy javësh. Trajneri i Francës Didier Deschamps ka zbuluar se Lloris ka pësuar një tërheqje muskulore gjatë fitores 3-1 ndaj Real Madridit, duke bërë që portieri të humbasë edhe ndeshjet miqësore të përfaqësueses së tij. Siç duket tani, 30-vjeçari do të humbasë ndeshjet ndaj Kristal

Palas dhe Arsenal më 18 nëntor në Premier Ligë. Spars do të ndeshen me Borussia Dortmundin tre ditë më vonë në “Champions League”. “Hugo është dëmtuar dje. Ai ka bërë testet që kanë konfirmuar një tërheqje muskulore,” është shprehur Deschamps. Tottenham gjithashtu ka humbur qëndërmbrojtësin Toby Alderweireld gjatë fitores ndaj Real Madridit teksa mbrojtësi është zëvendësuar në pjesën e parë.

Zbulon formulën për eliminimin e dëmtimeve në ligamentet e gjurit

Të shumta këputjet e ligamenteve të krociatit? Duke mos mundur të minimizohet numri i ndeshjeve në kalendar, është e domosdoshme të shtohet numri i zëvendësimeve të lejuara. Kjo është receta e sugjeruar nga Piero Volpi, përgjegjësi i departamentit mjekësor te Interit, të dhënë gjatë një interviste të “Radio 24”. Sipas mjekut Volpi, mënyra e vetme për të parandaluar dëmtimet, është minimizimi i minutazhit që futbollistët luajnë në fushë. “Pritshmëritë e futbollit modern në lidhje me këtë tip dëmtimesh janë një rast në vit për çdo skuadër. Futbollit është



një sport traumatik, ndaj nevojitet të pritët që çdo vit të ketë fatkeqësisht një dëmtim me këputje të ligamenteve të krociatit për çdo skuadër. Prej vitesh diskutohet mbi mënyrën dhe mundësinë për të reduktuar këtë statistikë, duke studiuar terrenet e lojës, këpucët dhe

metodologjitë e stërvitjes”, sqaroi mjeku Volpi. “Vitet e fundit është konstatuar se dy faktorët më të rëndësishëm që ndikojnë direkt në këtë çështje janë fiziku i futbollistë dhe raporti mes ndeshjeve dhe stërvitjeve. Ditët e sotme luhet shumë ndërsa stërvitet më pak.

Për këtë arsye unë kam propozuar që para dy viteve, dhe e di që Federata, në lidhje me kategoritë diletante e ka bërë, mundësia e vetme, duke mos mundur të reduktohet numri i ndeshjeve, sepse të gjithë duan të luajnë me përfaqësuesen, në Evropë, kampionat dhe kupë, atëherë të shtohet numri i zëvendësimeve të lejuara. Duhet të mundësojmë që futbollistët të luajnë të gjithë nga pak, duke realizuar një rotacion të plotë, ndryshe, me vetëm tre zëvendësime të lejuara, është normale që trajneri do të aktivizonte gjithmonë të njëjtë futbollistë”, apeloi mjeku i Interit.

Shahin i jep lamtumirën Turqisë



Mesfushori i Turqisë, Nuri Shahin është tërhequr nga kombëtarja për t'i lënë vendin futbollistëve më të rinj. 29-vjeçari e gjeti golin në debutimin e tij me Turqinë, gjatë fitores 2-1 ndaj Gjermanisë, në vitin 2005, kur ishte 17 vjeç, duke u bërë futbollisti më i ri në historinë e Turqisë, që shënon për përfaqësuesen, pikërisht nga vendi ku u lind dhe u rrit. “Unë mendoj se me largimin tim do të ketë mundësi të

luajë dikush që i përket gjeneratës të ardhshme të Turqisë, për 10 vitet e ardhshme, ashtu si kam qenë unë gjatë 10 viteve të fundit”, deklaroi Shahin. Turqia nuk arriti të kualifikohet për në Kupën e Botës 2018. cekim, mesfushori i Borussia Dortmund luajti 51 ndeshje me Përfaqësuesen e Turqisë, por vetëm një prezencë ka bërë në veprimtaritë madhore, atë kundër Spanjës, në humbjen 3-0 në Euro 2016.

Evra si Kantona, godet tifozin e skuadrës së tij

Klubi dënon fyerjet e tifozëve ndaj lojtarëve

Si një tjetër francez që ka luajtur te Mançester Junajteti, Patris Evra ka goditur me shqelm ‘alla’ Erik Kantona një tifoz të skuadrës së tij. Cekim, edhe Kantona “ra viktimë” e ofendimeve të një tifozit të cilin e goditi me shkelm në gjoks, për të vijuar më pas në përdorimin e duarve. Asokohe, polemikat ishin të nxehtë, e madje kishte nga ata që kërkonin t'i jepej fund karrierës së Kantonas në moshën 29 vjeçare. Dënimi fillestar me 2 javë heqje lirie, u konvertua në 120 orë punë në komunitet dhe në fund u vendos që Kantona të pezullohej 9 muaj nga



futbollit. Ndërkohë, nuk është akoma e qartë përse ka ndodhur ngjarja, por raportet e para thonë se Evra ka goditur një tifoz të Marsejtit pasi disa ultras

arritën të zbrisnin poshtë tribunës pranë reklamave që rrethojnë fushën, në kuadër të ndeshjes së Liga Evropë me Guimaraesh. Nëse shikoni me vëmendje



pesë sekondat e para, 36-vjeçari Evra duket i qetë teksa ka sulmuar një nga tifozët duke e matur shqelmin fiks në kokën e tij si një luftëtar profesion-

ist i MMA. Ndërkohë, Gjatë ditës së djeshme ka reaguar edhe klubi francez Olimpik Marsej për rastin e ndodhur duke dënuar fyerjet ndaj lojtarëve.

“Marsej ka parë incidentin e ndodhur para ndeshjes mes Vittoria Guimaraesh – Marsej në Portugali. Jemi duke zhvilluar një hetim të brendshëm për të vendosur se kush është përgjegjës për atë që ka ndodhur. Në çdo rast futbollistët duhet ta mbajnë gjakftohtësinë përballë provokimeve dhe ofendimeve nga kushdo që vijnë ato. Në këtë moment klubi dënon ashpër ata mbështetës që i ofendojnë futbollistët e tyre, por ne besojmë se ai person nuk ka qenë një përkrahës i Marseille”, thuhet në komunikatën e klubit francez.



Të enjten pasdite, kur u kthym në Muni pas humbjes 3-0 në Paris, kam pasur një bisedë me Agnelli dhe situata nuk ishte e mirë. Në fund të bisedës, Agnelli u ngrit në këmbë dhe tha: "OK, tani nuk je më shefi im, por do të mbetesh një mik i mirë."

Aguero e zgjati kontratën e tij për një vit, deri në vitin 2020, mbi 18 muaj më parë, por një njoftim zyrtar nuk është bërë kurrë nga klubi. Teksa u pyet në shkurt, se kur skadon marrëveshja e tij, Agguero tha në vitin 2020, por i ka pohuar medias argjentinase se kjo ndodh në fakt më 2019

Sergio Agguero beson se ai është në formën e jetës së tij, pasi ka thyer rekordin e Manchester Sityt, por ka shtuar edhe njëherë konfuzionin mbi situatën e kontratës, duke thënë se "nuk e di se sa vite kanë mbetur në marrëveshjen e tanishme". Agguero e kapërcëu rekordin e Erik Bruks, i cili kishte qëndruar për 78 vjet në fuqi, duke shënuar golin e tij të 178-të për

S'e di kur përfundon kontrata ime me Sityn!



Mançesrer Sityn, në fitoren 4-2 në Napoli, të mërkurën në mbrëmje. Me 9 gola në 11 ndeshje deri tani, në sezonin aktual,

Agguero beson se është në krye të lojës së tij tani. "Po, unë mendoj kështu", - u përgjig argjentinasi kur u pyet nga gazetarët

për formën e tij. - Këtë sezon mendoj se po luajmë shumë mirë, por sezonet e tjera janë të ndryshme. Kjo vjen për shkak se tani kemi një trajner të ndryshëm, lojtarë të ndryshëm. Këtë sezon kemi lojtarë të rinj, që janë shumë të mirë. Sezioni sapo ka filluar, dy muaj e gjysmë ka, apo diçka më shumë, kështu që ka ende një rrugë të gjatë për t'u përkthyer. Individualisht dhe kolektivisht mendoj se e kemi filluar shumë mirë, por duhet të vazhdojmë

kështu. Ne të gjithë e dimë se ka shumë lojtarë në Angli dhe ne duhet të jemi në gjendje të mirë fizike për atë që do të vijë", deklaroi sulmuesi argjentinasi. Edhe pse e ardhmja e 29-vjeçarit duket të jetë në Mançesrer, megjithatë rrethanat që kanë të bëjnë me marrëveshjen e tij të tanishme me klubin janë të paqarta. Agguero e zgjati kontratën e tij për një vit, deri në vitin 2020, mbi 18 muaj më parë, por një njoftim zyrtar nuk është bërë kurrë nga klubi. Teksa u pyet në shkurt, se kur skadon marrëveshja e tij, Agguero tha në vitin 2020, por i ka pohuar medias argjentinase se kjo ndodh në fakt më 2019. I pyetur nëse mund të sqaronte situatën mbrëmjen e së mërkurës, ai vetëm i turbulloi ujërat me tej: "Nuk e di, nuk mbaj mend!", përfundoi ai.

Shkurt

Torino blinton Lajçin

Adem Lajç është një nga lojtarët më të rëndësishëm që ka në dispozicion aktualisht Torino e Sinisha Mihajloviç. Bashkë me Belottin dhe Iago Falkuen, Lajç formon një treshe të frikshme në sulm dhe presidenti Urbano Kairo po bën gjithçka për të mbajtur në skuadër lojtarin serb pavarësisht interesimit të skuadrave të mëdha. Torino ka gati një kontratë të re për të blinduar ish lojtarin e Interit. Lajç dëshiron të vijojë aventurën e tij me skuadrën "Granata" dhe gjasat janë që ta zgjasë marrëveshjen aktuale me Torinon e cila i skadon në vitin 2020.

La liga tregon se kur do të luhet "El Clasico"

Takimi i parë i Real Madridit dhe Barcelonës këtë sezon do të luhet në orën 13:00 të shtunën më 23 dhjetor, këtë e ka konfirmuar vetë La Liga. Real do të presë Barcelonën në javën e 17-të, pikërisht në prag të Krishtlindjeve, pasi Los Blancos do të jenë rikthyer nga Kupa e Botës për klube, finalja e së cilës do të luhet më 16 dhjetor.

Siti hedh sytë nga Bertrand

Rajan Bertrand mund të jetë përforcimi i radhës për Mançesrer Sityn në merkaton dimërore. Sipas "The Sun", skuadra e drejtuar nga Pep Guardiola është e gatshme të derdhë në arkat e Soutemptonit plot 33 milionë euro për shërbimet e mbrojtësit. Bertrand konsiderohet nga "Cityzens" si zëvendësuesi ideal i Benjamin Mendi, i cili do të mungojë për shumë kohë, për shkak të dëmtimit të pësuar.

Poketino përfundon i pari në listën e Perezit

Trajneri argjentinasi i Totenhem Hotspur, Mauricio Poketino ka përfunduar në radarin e presidentit të Real Madridit, Florentino Perez. Skuadra angleze mposhti 3-1 Real Madridin në ndeshjen e Ligës së Kampionëve, dhe kjo fitore ka parë Poketino të dal në krye të listës së ngushtë të kandidatëve të Perezit për të pasuar trajnerin Zinedin Zidan në Real. Sipas tabloidit an-

glez "Daily Mail", Perez ka një marrëdhënie të shkëlqyeshme me Poketino, duke iu referuar atij si "Poch" kur dy skuadrat u takuan në Madrid dy javë më parë. "Unë kam shumë respekt për Florentinon. Jam i kënaqur nëse ndihet në të njëjtën mënyrë. Ai është gjithnjë miqësor ndaj meje", ka thënë Poketino për "Radio Marca". Poketino gjithashtu i ka impresionuar

tifozët e Realit duke deklaruar se kurrë nuk do mund të konsiderojë të punojë për Barcelonën për shkak të së kaluarës së tij me Espanjolin. Pavarësisht se Zidan fitoi shtatë trofe në 19 muajt e tij të "Mbretërisë", ka pyetje në lidhje me aftësinë e tij për të udhëhequr skuadrën e re që klubi ka mbledhur. Dhe këto dyshime u intensifikuan pasi Poketino i dha një mësim futbollit



Zidanit në ndeshjen e mesjavës në "Wembley". Në të vërtetë, pas kësaj, një editorial për gazetën

spanjolle "Marca", e cila është i afërt me Realin dhe Perezin, e ka quajtur trajnerin francez "të paditur".

Publicitet

Ç'ËSHTË QSFIDA ?

QSFIDA - BARË INOVATIVE PËR KRIJIMIN E NJË ZGJIDHJE TEKNOLOGJIKE INOVATIVE PËR PROBLEMIN ME NDOTJEN E AJRIT NË MJEDISËT URBANE.

Ç'FARË ZGJIDHJE KËRKOJMË?

GARUESIT DUHET TË OFROJNË ZGJIDHJE NË NJË PREJ FUSHAVE NË VIJIM:

- SHFRYTËZIMI I ENERGJISË PËR NGROHJE: ZGJIDHJE ME TË CILAT ULEN TRANSMETIMET E SUBSTANCAVE NDOTËSE QË DALIN SI REZULTAT I NGROHJES NË AMVISËRI DHE/OSE NË REPARTET INDUSTRIALE;
- TRANSPORT DHE MOBILITET: ZGJIDHJE ME TË CILAT ULEN TRANSMETIMET E SUBSTANCAVE NDOTËSE TË SHKAKTUARA NGA KOMUNIKACIONI;
- NËDËRTIMTARI DHE ALTERNATIVAT URBANE: ZGJIDHJE ME TË CILAT ULET NDOTJA E SHKAKTUAR NGA EKSPANSIONI NËDËRTIMOR.

SI TË PARAQITENI?
www.fitr.mk/o2predizvlk

BUXHETI PËR SHPËRBLIMIN
BUXHETI I PËRJOJTIKËSHËM I SHPËRBLIMIT PËR QSFIDA ËSHTË 6.000.000 DENARË

AFATI PËRFUNDIMTAR
FORMULARËT E PLOTËSUAR SË BASHKU ME DOKUMENTET E BASHKËNGJITURA PARASHTRONEN NË E-MAIL ADRESËN: o2predizvlk@fitr.mk
DËRËZIMI BËHET DERI NË 30.11.2017 DERI NË ORA 23:59

KONTAKT ZYRA NË REKORD
RR. DIMITRIE ÇUPOVSKI
NR. 8 SHKUP, R. E MAQEDONISË


ORARI I PUNËS
E HËNË - E PREMTE 8:30 - 16:30

TEL: +389 2 322 33 73

ФОНД ЗА ИНОВАЦИИ И ТЕХНОЛОШКИ РАЗВОЈ

Roma donë t'ia rrëmbejë Atletikos Himenezin

Nëse Roma arrin të kalojë fazën e grupeve të Çampionsit, në arkat e klubit verdekuq do të shkonin edhe 15 milionë euro, shumë që stimulon drejtuesit të ndërhyjnë në merkato, për të plotësuar organikën me elementë mjaft cilësorë në reparte të veçanta. Sipas mediave italiane, drejtori sportiv i Romës, Monçi, ka shënjestruar mbrojtësin uruguaian, Hose Himenez, i ditëlindjes 1995 dhe në skadencë kontrate me Atletikon e Madridit. Roma është interesuar edhe gjatë sezonit të kaluar për këtë futbollist falë lidhjeve spanjolle të



Monçit, i cili ka pasur një kontakt me drejtuesit e "Los Colchoneros" me rastin e përbaljes së parë mes Romës dhe Atletikos në "Olimpico". Ndoshta biseda për këtë futbollist do të vijojë më 22 nëntor, kur Roma të kërkojë pikën e kualifikimit në "Wanda Metropolitan".

Sandro vazhdon të jetë objektivi i Abramoviçit

Gjiganti anglez, Çellsin nuk ka rënë në planet e tyre për të nënshkruar me mbrojtësin e majtë të Juventusit, Aleks Sandro. Sandro vazhdon të jetë objektivi kryesor i kampionati aktual anglez, Çellsin dhe trajnerit të tyre, Antonio Konte. Me kontratën e re të pa nënshkruar ende, drejtuesit e Çellsit janë të bindur se Sandro ende mund të tundohet në janar nga destinacioni Londër. Sipas "The Mirror", përkundër një jave të vështirë, trajneri i Bluve, Antonio Konte ende ka mbështetjen e plotë të

bordit për shkak të vërshimeve të lëndimeve. Klubi ka të ngjarë të mbështesë atë në afatin e verës dhe ata do të japin para për të ringjallur interesin e tyre për mbrojtësin e majtë të Juventusit, Aleks Sandro. Blutë dëshirojnë të sigurojnë konkurrencë të fortë në anën e majtë të mbrojtjes për Markos Alonso, por u refuzua në përpjekjet e tyre për të nënshkruar më parë me brazilianin. Viti 2018 prite të jetë i nxehtë për Çellsin, pasi duhet të konfirmohet si rival i denjë për titullin e Ligës Pre-



mier dhe Ligën e Kampionëve, pasi deri më tani janë larg pritjeve.

DASHI (20/III-20/IV)



Sot keni angazhime më të mëdha në punë. Megjithatë nuk do të mungojnë as kënaqësitë e ndryshme. Mos i bëni gjërat e mëdha me partnerin/ën. Kujdes më të madh për familjen.

DEMI (21/IV-20/V)



Jeni në një ditë kur do të kënaqni të tjerët me humor. Nëse shefi ju obligon me ndonjë punë kryeni atë. Duhet që t'i ofroni më shumë një personi i cili po ju vëzhgon.

BINJAKËT (21/V-20/VI)



Mos kushtëzoni të tjerët duke marrë vendime autonome. Bashkëpunoni sa më shumë me kolegët. Në dashuri keni harruar një person të cilit duhet t'i kushtoni më shumë kujdes. Rregulloni disa gjëra të brendshme shtëpiake.

GAFORRJA (21/VI-22/VII)



Duhet që të tejkaloni disa keqkuptime të cilat kanë filluar që nga mëngjesi. Ajo që duhet të bëni është që të jeni më i kujdesshëm gjatë pasdites. Pasi që keni shumë imunitet më punë mund t'i përballoni edhe gripit.

LUANI (23/VII-22/VIII)



Nuk do të keni ndonjë risi gjatë ditës së sotme. Keni energji të mira kështu që duhet të jepni maksimumin në punë. Por kujdes me partnerin/ën. Nëse jeni beqar do të keni një ditë të mirë për të arritur tek një lidhje serioze.

VIRGJËRESHA (23/VIII-22/IX)



Jeni në një ankth të ri ndryshimesh, kështu që kujdes. Yjet ju sugjerojnë që të kërkoni më shumë dashurinë sepse ajo papritur mund t'ju ikën. Duhet të keni një kujdes të shtuar për ushqimin.

PESHORJA (23/IX-22/X)



Keni ide të ngatëruara kështu që mund të merrni vendime që janë shumë të nxituara. Mund të ndjeni një dashuri të reja apo rikthim tek dashuria e vjetër. Megjithatë, nuk jeni në humor të mirë kështu që nuk do bëni shumë ndryshime.

AKREPI (22/X-21/XII)



Jeni në një gjendje shumë të mirë. Por, yjet ju sugjerojnë që mos t'i ekzagjeroni gjërat. Është një ditë e mirë po ashtu që të flirtoni. Pra jepuni më shumë pas aventurave. Shëndeti i mirë!

SHIGJETARI (22/XI-21/XII)



Jeni shumë praktik në kryerjen e punëve. Vazhdoni kështu. Në aspektin sentimental do të lind diçka e re. Nëse jeni çift mundohuni që të përmirësoni raportet me partnerin/ën. Kujdes me pastërtinë!

BRICJAPI (22/XII-20/I)



Do të arrini që të realizoni disa biznese të cilat i keni lënë pas dore. Kështu do të mund të ecni përpara. Në aspektin sentimental do të keni raporte pozitive. Shëndeti i mirë. Ditë e mirë për marrje me fitnes.

UJORI (20/I-19/II)



Është një ditë e mirë ku mund ta planifikoni të ardhmen. Kështu do të arrini që të krijoni një lidhje shumë të mirë. Yjet ju sugjerojnë që të konsumoni sa më shumë fruta për të larguar gripin.

PESHQIT (20/II-19/III)



Papritur do të gjendeni para një situata ku nuk do të mund të ktheheni prapa. Është mirë që të realizoni një takim që ka të bëjë me juve. Keni kujdes më të madh me gjumin pasi që mund të keni probleme!

Koha Koha	KËNGËTARI YNË NGA FOTO	NGJITEM, BËHEM ANËTAR	PANTALLONA TË SHKURTA FËMIJËSH (shum.)	KEMI QENË	RADIUM	HARMONI, ARGËTIM								
KËNGËTARE E NJOHUR KOLUMBIANE	○													
TITULL I SULLTANIT NË P. OSMANE	○				ENERGJI									
KTHINË E VOGËL NË NJË BURG	○				KËNGËTARJA, SHAHINI									
MANIAK ZJARRESH SHKRIMTARI AMER., FILIP	○			NJ. G. QË KA NUMËR TË NJEJTË RROKJESH										
KECE, DHI	○					KËNGËTARJA, TOSKA								
ZANORE E JONA	○	I FRESKËT FLETË LETRE PËR DUHAN									NJË KONTINENT (pashq.)	FIS INDIGJEN NË BURMA	NË TJETËR MËNYRË (lat.)	SHTAZARAK TRILLIM NGA MENDJA ATY PËR ATY
RËNTGEN, TEMP	○		MUAJI I AGJËRIMIT TË MYSLIMANËT RROTULLO- HEM											
RILINDËSI, POETI SHQIPTAR, PASHKO	○				VEÇIM TË BËRIT SI TJETRI									
ETIOPI	○											IMPERFEKT (shkurt.) MALL I MBETUR NË MAGAZINË		
NDRYSHIME MIDIS DY SENDEVE	○						YLL FILMI PUNËTOR NË HANE (vjet.)							
ELEMENT KIMIK (NI)	○	LUFTËTAR ME DEMA (SPANJË) DEKRETE, VEPRA								DRAMË E SHEKSPIRIT THEMELUES I FIATIT, XHOVANI				
KARAT	○									VOLT AKTORJA AMERIKANE, MUR				
UNITED AIRLINES	○				ÇIFT, DYSHE DETYRË E AKTORIT					KAM NJOHURI RREGULL, KANUN				
Koha Koha	VEPRAT E KRIMINELËVE SHABAN TËRSTENA							LYTH MILJE JAPONEZE						
LLOJ PËJE ALKOOLIKE						ZBUKURIMI ME NGJYRA TË NDRYSHËM GJERMANIA								
DREJTIM A DIRIGJIM QË NGA LARG I NDONJË MAKINE														

FJALËKRYO KLASIK

1	2	3	4	5	6	7	8	9
10								11
		12						
13	14		15					16
17		18		19			20	
21			22		23	24		
25					26			
27				28				
	29							

HORIZONTALISHT : 1. Hell zburues në shpella; 10. Ishull i vogël dhe i pabanueshëm Italian; 12. Pushim ndërmjet dy akteve teatrore; 13. Azot, bor; 15. Era e këndshme; 16. Jod, energji; 17. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës; 19. Tenistja ruse, Kurnikova; 20. Masë kineze për peshë; 21. Vjedhës; 23. Prirje e përgjithshme, tendencë; 25. Shkrimtari arbëresh, Karmine; 26. Pije e fortë alkoolike (scoceze); 27. Enti kombëtar aeronautik dhe hapsinor (SHBA); 28. Lëvrim; 29. Festë me të pirë te grekët e lashtë.

VERTIKALISHT: 1. Soloturn; 2. Lumë në Ukrainë; 3. Qytet në Norvegji; 4. Shkrimtare; 5. Qytet në Ohio (SHBA); 6. Pësia e diçkaje, e shprehur në gram; 7. Piloti finlandez në F1, Hakinen; 8. Lindje (huaj); 9. Tina Turner; 10. Futbollisti anglez, Stiv Mek; 11. Fyerje; 12. Dru tropikal; 16. Ushtarët federal në luftë civile (SHBA); 18. Dhoma ku nxënësit bëjnë mësim; 20. Dhjetë copë të një lloji (lugë, piruj etj.); 22. Sulm; 24. Monedhë e Iranit; 28. Kyc.

Dëmet që sjell konsumimi i tepërt i patateve

Konsumimi i patateve rrit rrezikun e presionit të lartë të gjakut, sipas të dhënave të një studimi të publikuar nga The Independent.

Katër ose më shumë vakte që përfshijnë patate të skuqura, të pjekura, ose të ziera, do të thotë 11 për qind shanse që tensioni i gjakut të rritet, thonë ekspertët. Ata gjithashtu zbuluan se burrat dhe gratë që hanin katër ose më shumë vakte me patate të skuqura, kishin një rrezik



prej 17 për qind më të lartë për t'u prekur nga presioni i lartë i gjakut. Hulumtuesit gjithashtu vunë në dukje se zëvendësimi i një vakti me

patate, me një kategori tjetër perimesh, çon në një reduktim prej 7 për qind të presionit të lartë të gjakut. Gjithashtu, një studim i veçantë zbuloi se gratë të cilat konsumojnë shumë patate mund të jenë përballë një rreziku në rritje të prekjes nga diabeti. Sipas ekspertëve, personat që konsumojnë më shumë se pesë vakte me patate në një javë kanë rreth 50 për qind më shumë shanse për të pasur probleme të ndryshme shëndetësore.

Edhe papagalli do të shkojë në UMRE së bashku me pronarin



Pasha, një papagall gri afrikan, është gati të kryejë Umren gjatë udhëtimit të tij të parë në Mekë, teksa qëndron i vendosur mbi supin e pronarit të tij nga Turqia qendrore. Kuddusi Issi, i cili shtet pemë të thata në dyqanin e tij në Niğde të Turqisë, tha për Anadolu Agency (AA) se ai dhe papagalli i tij i pandashëm kanë caktuar planet e tyre. Pavarësisht se si mund të tingëllojë kjo ide, Issi e konsideron të natyrshme që ai të kryejë Umren këtë nëntor me shpendin e tij më të preferuar. "Pasha nuk mund të qëndrojë i ndarë nga unë", thotë Issi. Ai tregon se të gjitha dokumentet e nevojshme zyrtare për ta marrë Pashën në vendin më të

shenjtë të Islamit, Mekë, janë kompletuar. Duke folur për përkushtimin e papagallit ndaj tij, Issi tha se Pasha madje as nuk ha nëse ai nuk është i pranishëm për ta ushqyer. "Ai ha vetëm atë që i jap unë... Edhe pse qëndron në një dyqan me pemë të thata, ai nuk ha vetë", thotë pronari i dyqanit për papagallin e tij gri me bisht të gjatë dhe të kuq. "Nëse largohem nga dyqani, ai nuk ndihet i lumtur, nuk ha asgjë dhe as nuk këndon, por nëse më sheh mua, ai bën gjithçka", rrëfen Issi. "Këto lloje të papagajve janë të varur nga pronarët e tyre dhe bien në dashuri me ta", thotë Issi. Duke folur në lidhje me talentet e papagallit të tij

të pandashëm, ai tha se Pasha është ekspert në imitimin e zërave të ndryshëm dhe madje mund të flasë qindra fjalë. "Tani mund të flasë 400 fjalë, e madje të imitojë zërat e telefonit, automjeteve, të qarave, të maceve, qenve, zogjve dhe të deleve", tha Issi. Issi tregon se Pasha në kohën e lirë pëlqen të relaksohet dhe të shikojë televizor si shumica e njerëzve dhe në veçanti kënaqet me lajmet. Pasha ka qenë vetëm 70 ditë i vjetër kur Issi e ka blerë atë. Ai ka mbushur tre vjet së fundmi, moshë e cila është ende mjaft e re për specien e tij, e cila është e njohur për jetëgjatësi deri në më shumë se gjysmë shekulli ndonjëherë.

Mësimdhënësja dënohet, shkroi fjalën "budalla" në ballin e nxënësit

Një mësimdhënëse në St. Petersburg të Rusisë është dënuar me 17 dollarë pasi ka shkruar fjalën "budalla" në ballin e një nxënësi.

Olga Alferova, e cila jep mësim në shkollën Keeper, kishte përdorur një laps të zi për të shkruar në ballin e nxënësit të saj. Ajo raportohet të ketë ndërmarrë këtë si masë për të "vetëdijësuar" nxënësit që të mos bëjnë



vizatime në duar. Gjykata mori vendim se mësimdhënësja ka ofenduar dinjitetin e nxënësit dhe e dënoi atë me 1000 rubla, ose 17 dollarë. Alferova më herët kishte dhënë dorëheqje nga puna e saj, pasi që nëna e djaloshit e kishte pyetur: "Çfarë ka bërë Lyosha im për t'ju ofenduar juve?" Mësimdhënësja i ishte përgjigjur me fjalët: "Asgjë, ishte ashtu si ishte".

KALENDARI HISTORIK 4 NËNTOR

- 1501 - Philip de Blank dhe Juana "la Loca" largohen nga Spanja.
- 1520 - Mbreti danez/norvegjez Kristiani II kurorëzohet si Mbret i Suedisë.
- 1529 - Arrestohet Kardinali Anglez Thomas Wolsey.
- 1619 - Frederik V kurorëzohet mbret i Bohemisë.
- 1841 - Treni i parë arrin në Kaliforni
- 1854 - Ndërtohet fanari në Ishullin Alkatraz.
- 1861 - Themelohet Universiteti i Uashingtonit në Sietl.
- 1866 - Mbretëria e Italisë përvetëson Venedikun.
- 1890 - Britania e Madhe shpall Zanzibarin si protektorat.
- 1914 - Rusia i shpall luftë Turqisë.
- 1921 - Kryeministri japonez Hara Takashi vritet në Tokio.
- 2008 - Barack Obama bëhet Afrikan-amerikani i parë që zgjidhet President i SHBA-ve.

A E DINI SE...



Gjuha me alfabetin më të gjatë është gjuha "Khmer" e Kamboxhias me 74 shkronja. Alfabeti më i shkurtër është me 12 shkronja i gjuhës "Rotokas". Gjuha me më shumë fjalë është anglishtja që shkon rreth 250.000 fjalë.

Në SHBA fliten mbi 300 gjuhë, ndërsa Afrika e Jugut mban rekordin si vendi me më shumë gjuhë zyrtare (11).



Të mësosh një gjuhë të dytë mund t'ju bëjë më të zgjuar. Disa shkencëtarë mendojnë se të jesh poliglot mund të rrisë fuqinë e trurit. Studime të tjera sugjerojnë se po të flasësh më shumë se një gjuhë mund të ngadalësojë plakjen e kujtesës.

BARSOLETA



PROFESORI PYET BENIN

- Beni, çfarë të ndodh nëse të shkul një vesh?
- Do bëhem gjysëm shurdh profesor?
- Po nëse të shkul edhe veshin tjetër?
- Do ngelem qorr profesor...
- Profesori i trembur e pyet:
- E si ka mundësi që do ngelesh qorr?
- Po ngaqë s'kam ku ti var syzet profesor!

THËNIA E DITËS

Fatkeqësisht politika dhe fatet e njerëzimit merren në dorë nga njerëzit mediokër dhe pa ideale. Njerëzit e mëdhenj, nuk i futen kurrë politikës. (Albert Camus)

